



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Univeriteti Barleti”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr.Gezim Dibra**

**Prof.As.Dr.Florinda Tarusha**

**Dhjetor / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”	
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit	
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”	
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr 486 datë 30.08.2022	
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:		
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë	
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë	
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite	
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite	
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë	
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip	
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7	
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti Akademik	Raporti
			PAE      PAK
		2022-2023	3      2
	2023-2024	5      6	
18	Numri i studentëve:	Viti 2022-2023 - 11 studentë. Viti 2023-2024 - 12 studentë	
19	Komente / të tjera:	-	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit Barleti ” (në vijim UniBa) dhe së dyti sipas veprimtarive të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UniBa. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë me emërtesë Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor. Programi i studimit është hapur me Urdhër të MASH Nr. 468, date 30.08.2022. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit pranë UniBa-s.

Aktualisht, programi Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program synon të përgatisë punonjës socialë të cilët me njohuritë e marra dhe aftësitë e formuara do të kontribuojnë në zgjidhjen e problematikave të shkollës lidhur me trajtimin e nxënësve. Bazuar në objektivat e përcaktuara strukturën dhe përmbajtjen ky program synon të pajisë studentët me dije, aftësi, shkathtësi dhe kompetenca në përputhje me nevojat e tregut të punës, dhe të sistemit arsimor në veçanti.

Programi përmban gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike me 4 semestra. Në përfundim të ciklit të studimit dy vjeçar studentit pajiset me diplomë universitare “Master i Shkencave” në “ Punë Sociale në Sistemin Arsimor”.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në dy vitet e funksionimit të tij , është:

- Për vitin akademik 2022-2023 është 11 studentë
- Për vitin akademik 2023-2024 është 12 studentë

Gjithsej 23 studentë. Të diplomuar nuk ka pasi viti 2024 është viti i parë i diplomimit të studentëve.

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

### *Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof.Dr. Gëzim Dibra dhe Prof.Asoc. Florinda Tarusha dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, znj. Rajna Lila. Vizitat u realizuan në datat 25 dhe 26 Mars 2024. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije nga ekspertja e ASACL.


*Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” në FSHSTS, të UniBa-së, është:*

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 571 datë 12.08.2005 “Për Vendimin e hapjes së shkollës së lartë universitare jopublike Universiteti “Marin Barleti”
- Urdhër MASH Nr. 309, datë 27.07.2012, për Riorganizimin e Brëndëshëm të njësisë kryesore të shkollës së lartë jopublike Universiteti “Marin Barleti”
- Urdhër MASH Nr. 468, datë 30.08.2022, për *licencimin e Programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”, si program i ciklit të dytë i studimeve Master i Shkencave në Universitetin “Barleti”*.
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UniBa-së dhe Rregulloret në UniBa-së.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

### ***Aktivitetet kryesore të realizuara***

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambjentet e brendshme të UniBa dhe FSHSTS-së.

**Analiza e të dhënave parësore** është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” (Janar 2024), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.



**Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:**

- Takim me Drejtues te institucionit që mbulojne programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit dhe Sherbimeve studentore;
- Takim me Përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore;
- Takim me Zyren e Kerkimit Shkencor;
- Takim me përfaqësues të Njesisë të zhvillimit të kurrikulës;
- Takim me perfaqesues te Zyres se Komisionit te sigurimit te cilesise;
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe i bibliotekës;
- Takim përfundimtar me Drejtorin e Departamentit.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizimi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

**Vëzhgimi i mjediseve mësimore** në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të arteve, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FSHSTS-së dhe të UniBa-së.

Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Statutit <sup>1</sup> Programi i studimit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” ka synuar konsolidimin e vlerave akademike dhe është në linjë me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit. UniBa ka për mision përgatitjen e studentëve jo vetëm si profesionistë por edhe si qytetarë të angazhuar në një botë në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Në vizionin e tij UniBa është një institucion cilësor dhe një aktor zhvillimi që ofron vlera profesionalizmi dhe qytetarie, duke përgatitur individ të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas Statutit <sup>2</sup> dhe Rregullores Programi i studimit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” mundëson ofrimin e programeve të studimit me cilësi të lartë dhe të integruara me praktikën. Ai synon të formojë specialistë në fushën e punës sociale me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën përkatëse. Në këtë këndvështrim, ky program është në linjë me qëllimin, misionin, si edhe me fushën e veprimtarisë së institucionit. Programi është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe për t’iu përgjigjur kërkesave dhe detyrimeve që burojnë nga Ligji për Urdhërin e Punonjësve Socialë <sup>3</sup> . Programi është gjithashtu në përputhje me shtyllat kryesore të aktivitetit të UniBa të parashikuara në Statut dhe në rregulloren e Universitetit <sup>4</sup> .

<sup>1</sup> Statuti UniBa, (Referuar: Evidenca nr 1.4)

<sup>2</sup> Statuti UniBa, (Referuar: Evidenca nr 1.4)

<sup>3</sup> Rregullore e programit MSh në Punë Sociale në Sistemin Arsimor (Referuar: Evidenca nr 1.3)

<sup>4</sup> Ligji i Urdhrit të Punonjësve Socialë, ( Referuar: Evidenca nr 25 )

<sup>4</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit “Barleti”, KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 4.


<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSh në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UNIBA-se.</p> <p>Nisur nga objektivat e programit të studimit të renditura në rregulloren<sup>5</sup> e tij, programi hartohet dhe ofrohet në përshtatje me tre shtyllat të Statutit<sup>6</sup> dhe të rregullores UniBa<sup>7</sup>, përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Shtylla akademike e fokusuar në strukturën dhe ofertën akademike</li> <li>Shtylla e studentit në qëndër e fokusuar në veprimtarinë studentore dhe komunitare</li> <li>Shtylla e kërkimit të aplikuar dhe inovacionit, e fokusuar në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuara.</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i Studimit MSh në Punë Sociale në Sistemin Arsimor ka ndjekur trendin kombëtar dhe ka ofruar mundësinë më të mire, duke pasur parasysh zhvillimet e vendit në aspektin politiko-ekonomik, Urdhërin e Punonjësve Socialë dhe standardet etike ndërkombëtare me synim përgatitjen e punonjësve sociale.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor është hartuar në përputhje dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit Institucional. Programi i studimit synon konsolidimin e vlerave akademike dhe është në linjë me zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<sup>5</sup> Evidenca 3. Rregullore e Programit MSh në psikologji Klinike, Tiranë 2022, KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 2, Neni 3.

<sup>6</sup> Evidenca 1.4 Statuti i Universitetit “Barleti” 2020, KREU I, Dispozitë e Përgjithshme, Neni 6.

<sup>7</sup> Evidenca 1.3. Rregullore e Universitetit “Barleti”, KREU I, Dispozita e Përgjithshme, Neni 4.





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e nje programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Misioni i UniBa<sup>8</sup> (Neni 4 I Statutit ) është të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës, të aftë për sfidat e të tashmes dhe të ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe në zhvillim të vazhdueshëm”, karakteristikë kjo e zhvilluar gjerësisht në strategjinë e institucionit.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UniBa, përfshi edhe programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor janë në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto programe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në vetëvete është i përbërë nga katër Departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve</li> <li>2. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit</li> <li>4. Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit</li> </ol> <p>Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit është ai brenda të cilit ofrohet ky program Studimi<sup>9</sup>. Në përbërjen e tij <b>Departamenti për vitin akademik 2023-2024 ka ka 7 anëtarë personel me kohë të plotë</b> prej të cilëve 1 është me titull Prof. Asoc. Dr. 5 janë me titull PhD/Dr. dhe një anëtar ka gradën Msc<sup>10</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Referuar kontekstit historik, Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor me dy vite akademike është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Programi realizohet me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike<sup>11</sup>. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve. nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit. <sup>12</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor me dy vite akademike është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.</p> <p>Përputhja shihet në disa aspekte:</p>

<sup>8</sup> Evidenca 1.4 Statuti i IAL.pdf

<sup>9</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit.pdf

<sup>10</sup> 6. Lista e plote e stafit te departamentit te shkencave te sjelljes dhe shendettit.pdf

<sup>11</sup> Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Psikologji Klinike.pdf

<sup>12</sup> Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030 ( Ref. Evidenca 5.1. Faqe 10,11)





<p>fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>a) plotëson synimin për të përgatitur specialistë të zotë për tregun e punës brenda vendit dhe në rajon;  b) është konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale të tregut të punës;  c) është konceptuar si një model që kombinon mësimin me kërkimin,  d) paraqet një ofertë akademike elastike që ndërtohet duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut, aftësimin praktik dhe interesat e studentëve;  e) i përgatit studentët për të kontribuar për një sistem arsimor të efektshëm dhe më të zhvilluar ;  f) ka të integruar dimensionin ndërkombëtar<sup>13</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky program është brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë bazë dhe njësisë kryesore ku ofrohet. Nuk rezultojnë që FSHSTS dhe Departamenti i Sjelljes dhe Shëndetit të ofrojnë “Master Shkencor” jashtë profilit të UniBa-së. Programi i përgjigjet nevojave të tregut duke formuar profesionistë të aftë për t’u përballur me sfidat e profesionit<sup>14</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Angazhimi i UniBa me këtë grupim është institucional, i përkushtuar dhe ambicioz. Synimi është ofrimi i ndihmës në kualifikimin e vazhdueshëm të të diplomuarve, gjë e cila realizohet edhe përmes trajnimeve që UniBa ofron në fushat specifike të programit ku ata u diplomuan. Me këtë synim, është krijuar Akademia e Mirëqënies dhe Shëndetit dhe Sportit.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Rezultoni se Departamenti i Sjelljes dhe Shëndetit, që është njësi përgjegjëse për zhvillimin e Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, ka përvojën, kapacitetet, si edhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit të studimit. Programi i Studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UniBa, si edhe në përputhje me fushën akademike të studimit të FSHSTS dhe të Departamentit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>


**Standardi I.3**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------

<sup>13</sup> Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2030, ( Referuar: Evidenca 5.1)

<sup>14</sup> Evidenca 1. Strategji e Zhvillimit të Programit të Studimit Msc Psikologji Klinike.



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamenti që mbulon zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Programit të studimit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”, e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet kryesore rregullatorë të institucionit që janë Rregullorja e UniBa<sup>15</sup>, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve,<sup>16</sup> Rregullorja e Departamentit<sup>17</sup> si edhe Rregullorja e Programit të studimit.</p> <p>Rregullorja e UniBa përcakton kriteret kryesore të funksionimit të universitetit në tërësi, duke treguar se institucioni e zhvillon veprimtarinë përmes zbatimit të vendimeve, urdhrave edhe udhëzimeve të veçanta. Kjo rregullore përcakton edhe disiplinimin e marrëdhënieve të organeve dhe autoriteteve drejtuese me njësitë përbërëse të tij. Rregullorja e UniBa-së përcakton se rregulloret e brendshme të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë miratohen nga Senati Akademik, ndërsa rregulloret e brendshme të funksionimit të strukturave ndihmëse akademike me karakter administrativ rregullohen përmes rregullores së njësisë kryesore.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve përcaktohet se subjekte të rregullores së fakultetit janë organet dhe autoritetet drejtuese të FSHSTS, personeli akademik dhe administrativ, këshillat, komisionet, studentët, si edhe bashkëpunëtorët e fakultetit. Gjithashtu, në rregulloren e fakultetit përcaktohet me detaje mënyra e rregullimit dhe e kontrollit të jetës së brendshme të karakterit akademik dhe administrativ të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Rezulton se në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues, UniBa ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi prej vitesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëdhënie janë sanksionuar edhe në Statutin e UniBa-se. Aktualisht, UniBa<sup>18</sup> ka një gamë të gjerë marrëveshesh bashkëpunimi (MoU)<sup>19</sup> me universitete të ndryshme në Evropë. Me zgjerimin e programit Erasmus+ pedagogë dhe studentë kanë pasur mundësinë të shkëmbejnë përvojë dhe mësojnë nga kolegë e studentë nga universitetet bashkëpunuese në Europë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit,</p>	<p>Për zhvillimin e praktikës profesionale institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucioneve. UniBa<sup>20</sup> ka nënshkruar</p>

<sup>15</sup> Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22, ( Referuar: Evidenca 1.3)

<sup>16</sup> Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit ( Referuar: Evidenca 1.1)

<sup>17</sup> Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, ( Referuar: Evidenca 1.2)

<sup>18</sup> Internationalization Strategy UniBa (Referuar Evidenca 10.1)

<sup>19</sup> Të dhëna mbi mbi marrëveshjet e bashkëpunimit (MoU), mobilitetin e stafit dhe studentëve dhe marrëveshjet në kuadër të projektit Erasmus + (Referuar Evidenca 10.2)

<sup>20</sup> Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, (Referuar Evidenca 1.2)

<p>institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, që mundësojnë realizimin e praktikave për studentët që ndjekin këtë program studimi. Përveç parashikimeve në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale<sup>21</sup> janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Gjithashtu UniBa ndër vite ka përvoja të mobilitetit të stafit dhe të studentëve në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projektet e përbashkëta.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti në fund të çdo viti akademik zhvillon analizën e punës vjetore të tij, në të cilën shqyrtohet edhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit.<sup>22</sup> Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, edhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve paraqet raportin vjetor<sup>23</sup> të veprimtarisë mësimore-shkencore, në të cilin përfshihet edhe veprimtaria vjetore e Departamentit të Sjelljes dhe Shendetit. Përfitimet që ofrohen përmes realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit, janë trajnimet, leksionet e hapura me studentët, konsulentat e vazhdueshme midis palëve për realizimin e objektivave dhe aftësimin profesional të studentëve, mundësitë e punësimit të studentëve,<sup>24</sup> etj.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kuadri i përgjithshëm rregullator i UniBa është i plotë dhe ekziston një ndarje e qartë e detyrave që duhet të kryejë çdo njësi e institucionit. Në funksion të zbatimit të programit të studimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë brenda dhe jashtë vendit. Në përfundim të çdo viti akademik, nga njësia kryesore dhe njësia bazë, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë së formimit të studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<sup>21</sup> Paketa e praktikës, (Referuar Evidenca 13.2)

<sup>22</sup> Marrëveshje brenda vendit (Referuar Evidenca 10.3)

<sup>23</sup> Raporti i punës vjetore të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 28)

<sup>24</sup> Vendim Bordi i Karrierës (Referuar Evidenca 29)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor<sup>25</sup> është i organizuar në lëndë mësimore të cilat ndahen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmbyllëse. Përfundimi me sukses i Programit të Studimit parashikon dy vite akademike dhe në përfundim të tij studenti fiton 120 kredite ECTS.</p> <p>Baza ligjore e Rregullores së Masterit Shkencor (120 ECTS) është Ligji Nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”; VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar.; Udhëzimi Nr.31 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 29.12.2017, kreu III, pika 1, akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe Statuti dhe Rregullorja e Universitetit “Barleti”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit është zhvilluar në reflektim të situatës në arsim dhe ndryshimeve ligjore në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet në arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Programi<sup>26</sup> synon të aftësojë studentët për të zotëruar profesionin e punonjësit social në sistemin arsimor, si në aspektin teorik ashtu edhe në praktik, duke i aftësuar të formojnë sjellje etike dhe profesionale, ndërkohë që i pajis edhe me njohuri</p>

<sup>25</sup> Plani mësimor (Referuar Evidenca 2.1)

<sup>26</sup> Plani mësimor, (Referuar Evidenca 2.1)



<p>kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>plotësuese në drejtime të veçanta sipas kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, këto njohuri studentët i marrin përmes lëndëve me zgjedhje. Studentët gjithashtu kanë mundësi të angazhohen në aktivitete ekstra kurrikulare nga një rrjet i gjerë shërbimesh studentore që ofrohen për ta në Universitetin Barleti. Studentët e punës sociale janë pjesë aktive e Klubit të Psikologëve<sup>27</sup>, me një sërë aktiviteteve që kanë në fokus përfshirjen e studentëve për të vënë në praktikë njohuritë e fituara.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar me 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite, si edhe përcaktohet qartë se programi i studimit është i ciklit të dytë, i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në planin mësimor të programit të studimit janë të përcaktuara kreditet për praktikën profesionale dhe detyrimet përmblyëse. Gjithashtu, në rregullore përcaktohet se: <i>Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor" përmbillet pas përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në planin mësimor, fitimit të 120 krediteve (ECTS), me punim diplome dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në fushën e edukimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>

<sup>27</sup> Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe strukturat organizative, (Referuar Evidenca 19,1,2,3,4,5)

psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor (120 ECTS) është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Është program i ciklit të dytë të studimeve, realizohet me 120 kredite dhe ofrohet me kohë të plotë në katër semestra.
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor (120 ECTS) i përket nivelit 7 të Kornizës së Kualifikimit. Departamenti është përpjekur të realizojë kodifikimin e programeve të studimit që ai mbulon, ku përfshihet edhe ai programit që ne vlerësuam, priten aktet nënligjore nga ministria përgjegjëse, në vijim të VKM-së 310, datë 11.05.2022.
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit është organizuar me 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite, si edhe përcaktohet qartë se programi i studimit është i ciklit të dytë, i nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Gjithashtu, në rregullore përcaktohet se: Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor” përmbillet pas përmbushjes së detyrimeve të</i>



	<i>parashikuara në planin mësimor, fitimit të 120 krediteve (ECTS), me punim diplome dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në fushën e edukimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>												
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Struktura akademike e UniBa-s formohet nga katër fakultete dhe 13 departamente; struktura e njësive kërkimore formohet nga katër institute dhe dy qendra kërkimore.<sup>28</sup></p> <p>Bazuar në RVB te institucionit dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve dhe Departamenti Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike. Fakulteti i plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"<sup>29</sup>. Në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit bëjnë pjesë 4 departamente duke përmbushur kështu detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit</li> <li>b) Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit;</li> <li>c) Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional;</li> <li>d) Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve;</li> </ul>												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"><b>Kualifikimi i stafit</b></th> <th colspan="2"><b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (2023-20024)</b></th> </tr> <tr> <th><b>PAE</b></th> <th><b>PAK</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>4</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table>		<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (2023-20024)</b>		<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	Prof.Dr	1	2	Prof.Asoc	4	3
<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit (2023-20024)</b>												
	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>											
Prof.Dr	1	2											
Prof.Asoc	4	3											

<sup>28</sup> Organograma e UniBa. ( Ref,evidences nr.9 )

<sup>29</sup> Aneks Tabela permbledhese pdf. ( tabela 1 )

Dr/PhD	13	14
Dr. Proc	-	1
Msc	19	12
<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>32</b>
	<b>69 totali</b>	

Në përbërje të Departamentit janë 7 anëtarë me kontratë me kohë të plotë (për të dyja vitet akademike 2022-2023; 2023-2024) nga të cilët 1 është me titull Prof. Asoc. Dr, të paktën 4 janë me titull PhD/Dr.

**Departamenti Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit** në vitet akademik e 2022-2023 dhe 2023-2024 ka në stafin e tij si pedagoge si më poshtë:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	1	1	1
Dr./PhD. dhe ne proces	4	8	5	9
Msc.	2	5	1	5
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>14</b>	<b>7</b>	<b>15</b>
<b>Totali</b>	<b>21</b>		<b>22</b>	

*Rekomandohet që pedagogu me MSc të ndjekë procesin e doktoraturës ose të zëvendësohet sepse prania e tij në programet e studimit Master bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës".*

*Raporti personel akademik efektiv /studentë në nivel njësie kryesore është në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.30*

**Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit**

Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqëruar, rezulton se Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si njësi përgjegjëse për zhvillimin e Programit të studimit

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, angazhon personel akademik të jashtëm në rolin e kordinatorit për realizimin e praktikave mësimore. Gjithashtu, rezulton se nisur nga veçoritë e programit të studimit, mundësohen vetëm praktika laboratorike dhe klinike.			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga vizita në institucion dhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqëruës, si edhe nga ajo çfarë është paraqitur në RVB, rezulton se në strukturën e UniBa, në Rregulloren e departamentit është parashikuar një kordinator për çdo departament, i cili në fillim të vitit akademik miratohet nga Rektori i Institucionit, nëpërmjet një urdhri të brendshëm. Kordinatori i departamentit <sup>31</sup> koordinon punët e brendshme të departamentit dhe asiston përgjegjësin e departamentit për mbarëvajtjen e punëve. Në rastin e këtij programi studimi, kordinatori i departamentit është përgjegjës edhe për ecurinë dhe zhvillimin e programit; ndjek ecurinë e zhvillimit të orëve mësimore, komunikon me studentët për vështirësi të mundshme që hasin, etj. Më tej, kordinatori i departamentit raporton tek drejtuesi i departamentit ose gjatë mbledhjes së departamentit ku janë të pranishëm të gjithë anëtarët e departamentit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si njësi bazë e caktuar për zhvillimin e Programit të studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor duhet të përmbushë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. E gjithë veprimtaria e departamentit për përmbushjen e standardeve të kësaj fushe karakterizohet nga korrektësia dhe zbatimi faktik i ligjshmërisë në fushën e arsimit të lartë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>31</sup> Rregullore departamenti, neni 6, (Referuar Evidenca 1.2)

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><i>Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si njësi bazë e Programit të studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor ka dokumentacion të plotë për programin e studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor duke filluar nga shkresa që autorizon hapjen e programit pas aplikimit. Si njësi bazë, ky departament disponon rregulloren e programit, plan- programin, të dhënat për stafin akademik, ngarkesën mësimore, numrin e studentëve të regjistruar, shërbimet që u jepen atyre, raporte të monitorimit të performancës, etj</i></p> <p>Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë dhënë të plota dhe me të gjitha detajet e duhura gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Universiteti Barleti,  <a href="https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html">https://umb.edu.al/program-studimi/master-profesional/mp-ne-arsim-special.html</a></p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ ka akses të plotë jo vetëm tek Statuti dhe Rregullorja e institucionit, por edhe tek kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, programet lëndore, rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e tjera rregullatore të UniBa-s. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e tij. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në intranetin e universitetit.  (<a href="http://umb.edu.al/akademia-umb.html">http://umb.edu.al/akademia-umb.html</a>)</p> <p>Informacionet më të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit <i>Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor"</i> gjenden në dokumentet kryesore rregullatorë të UniBa-së dhe të njësisë kryesore/bazë, që më poshtë renditen sipas shkallës hierarkike të tyre:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rregullorja e UniBa-së<sup>32</sup>;</li> <li>2. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve (FSHSTS),<sup>33</sup></li> <li>3. Rregullorja e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit<sup>34</sup></li> <li>4. Rregullorja e Programit të Studimit<sup>35</sup>.</li> </ol> <p>Përveç dokumenteve të mësipërme rregullatorë, të dhëna më të detajuara jepen edhe në planin mësimor të programit të studimit, kurrikulën, si edhe në syllabuset e lëndëve<sup>36</sup>.</p>
--	--

<sup>32</sup> Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22, ( Referuar: Evidenca 1.3)

<sup>33</sup> Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit ( Referuar: Evidenca 1.1)

<sup>34</sup> Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, (Referuar Evidenca 1.2)

<sup>35</sup> Plani mësimor, ( Referuar: Evidenca 2.1)

<sup>36</sup> Syllabuset e lëndëve, (Referuar Evidenca 2.2)

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Ne planin mësimor i Programit të Studimit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin arsimor tregohet gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ ndarjen e lëndëve në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë integruese/ndërdisciplinore, lëndë plotësuese;</li> <li>○ kreditet ECTS të çdo lënde;</li> <li>○ orët në auditor/jashtë auditorit;</li> <li>○ ndarjen e lëndëve sipas semestrave.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e Institucionit<sup>37</sup> përcakton rregullat që duhet të ndiqen nga studentët lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Më me detaje, Rregullorja e programit të studimit<sup>38</sup> parashikon kushte dhe kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në programin e studimit në Kreu V, "Pranimi i studentëve", nga neni 24 deri në nenin 26. Procedura dhe kriteret për transferimin e studimeve përcaktohen në nenin 22 të këtij dokumenti. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluara në një IAL/ program të mëparshëm studimi parashikohet në rregulloren e FSHSTS.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë tregohen në rubriken e përshkrimit të moduleve në të cilën tregohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ lloji i lëndës/modulit;</li> <li>○ totali i krediteve (ECTS);</li> <li>○ emri i lektorit;</li> <li>○ qëllimi i modulit;</li> <li>○ rezultatet e të nxënit;</li> <li>○ literatura bazë dhe ajo e rekomanduar;</li> <li>○ metodologjia e mësimdhënies;</li> <li>○ mënyra e vlerësimit.<sup>39</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi bëhet në konsultim dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme apo udhëzimeve ministeriale. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik,</p>

<sup>37</sup> Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22, (Referuar Evidenca 1.3)

<sup>38</sup> Evidenca 3 Rregullore e Programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, , (Referuar Evidenca 3)

<sup>39</sup> S yllabuset e programit (referuar evidences 2.2)



akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Programi i studimit është licensuar në vitin 2022 dhe ky është viti i dytë i ofrimit të tij. Sipas akteve nënligjore institucioni ka të drejtë të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 % pas akreditimit të programit kështu që deri tani nuk ka patur ndryshim.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Plani mësimor i Programit të Studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor" tregohet në Përmbledhjen e Kurrikulës. Informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë tregohen në rubriken e përshkrimit të moduleve.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit II.3</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja. I konceptuar në këtë mënyrë, përfundimi me sukses i programit të studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor", u jep të diplomuarve mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin "Master Shkencor".
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Në programin mësimor Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor", organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 2 vite akademike, në 4 (katër) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë/semestër. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra (orë dhe kredite) është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. <sup>40</sup> Në përbërje të programit përfshihen: 2 lëndë bazë të kategorisë A me një total prej 12 kreditesh, 7 lëndë karakterizuese të kategorisë B me një total prej 61 kreditesh, 3 lëndë ndërdisiplinore të kategorisë C me një total prej 17 kredite, 1 lëndë plotësuese e kategorisë D me një total prej 12 kreditesh dhe detyrimet përmblylëse të kategorisë E me një total prej 18 kredite.

<sup>40</sup> Plani mësimor, (Referuar Evidenca 2.1)

20  




	<p>Kështu, Programi i Studimit përcakton<sup>41</sup>:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ për lëndët bazë 12 ECTS ose 10% të krediteve totale;</li> <li>○ për lëndët karakterizuese 61 ECTS ose 50.83% të krediteve totale; për lëndët ndërdisiplinore përcakton 17 ECTS ose 14.17% të krediteve totale;</li> <li>○ për lëndët plotësuese përcakton 12 ECTS ose 10% të krediteve totale;</li> <li>○ për detyrimet përmbyllëse përcakton 18 ECTS ose 1% të krediteve totale.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</b></p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore për studentët në dy vite dhe 4 semestra, vlerësimi në 60 kredite për vit dhe 30 kredite për semestër dhe planifikimi i studiuar i orëve mësimore mundëson arritjen e objektivave të programit të studimit. Struktura e programit,<sup>42</sup> lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ngarkesat janë konform kërkesave ligjore. Nga të dhënat në planin mësimor<sup>43</sup> me përlllogaritje rezultojnë 679 orë mësimore në auditor të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 450 orë leksione</li> <li>- 209 orë seminare</li> <li>- 20 orë projekte/detyra kursi</li> </ul> <p>Ngarkesa në orë në auditor dhe orë pune e pavarur e studentit respekton raportin 1 kredit 25 orë mësimore/punë të studentit si edhe kriteret në pikat b) c) ç) d) të vendimit nr. 41, datë 24.01.2018` Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë<sup>4445</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</b></p>	<p>Kurrikula e programit ka shumë ngjashmëri me programe të njëjta të kësaj fushe studimi që ofrohet nga universitetet publike në Shqipëri, gjë që i ndihmon studentët në transferimin e studimeve brënda vendit, por dhe në zhvillimin e mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus+.</p>
<p><b>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në</b></p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, konsultohen midis anëtarëve të departamentit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Në</p>

<sup>41</sup> Rregullore e Programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

<sup>42</sup> Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programit të studimit, (Referuar Evidenca 15)

<sup>43</sup> Evidenca 2.1 Plan mësimor MSH Psikologji Klinike


<sup>44</sup> RVB\_Msc. Psikologji Klinike (Aneks Tabelat Përmbledhëse, tabela 13)

<sup>45</sup> Evidenca 4. Studim Periodik i tregut për programin Msc. Psikologji Klinike, fq 2-3.

<p>mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, kërkohet që literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në Syllabuse të jetë e viteve të fundit. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit analizon performancën<sup>46</sup> duke u bazuar në ecurinë e programeve të studimeve dhe përfshijnë në to mendimin dhe opinionin e lektorëve, por edhe të studentëve lidhur me përmbajtjen lëndëve. Bazuar në opinionet dhe mendimet e marra njësia bazë merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të syllabuseve sipas moduleve. Literatura është paraqitur në çdo program lëndor krahas literaturës në bibliotekë, asaj online dhe asaj në intranet.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi. Fokusi i studimit të programit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor ”<sup>47</sup> është përgatitja e punonjësve social, të cilët me njohuritë dhe aftësitë e tyre tu përgjigjen nevojave për trajtimin e nxënësve në ambientet shkollore.</p>		
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit ofron njohuri dhe kompetencat profesionale për studentet duke mundësuar që pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve, këto të mund të punësohen në përputhje me kërkesat/nevojat e tregut të punës.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përfundimi me sukses i programit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor ” i mundëson studentëve që të vijojnë plotësimin e profilit të tyre akademik për në nivelet më të larta të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (nivelet 7-2 dhe 8), apo u jep atyre mundësinë për t’u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës. Programi i studimit ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë dhe programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim fitimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>

<sup>46</sup> Raporti i punës vjetore të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 28)

<sup>47</sup> Rregullore e Programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)



<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me pjesëtarë të strukturave drejtuese dhe personelin akademik të Departamentit, rezulton se në këtë departament ushtron veprimtarinë Bordi i Karrierës<sup>48</sup> me ish-studentët dhe personalitete në edukim, i cili ka si qëllim edhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve në funksion të integritetit të suksesshëm të studentëve në tregun e punës. Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, Departamenti ka të zhvilluar kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe këtë e ka dëshmuar me ndryshimet 20% në programet e tjera. Për programin në fjalë, duke qenë në proces zbatimi për akreditim, nuk ka bërë ndërhyrje, por ka ruajtur të dhëna të identifikuar që lidhen me përmirësimin e mëtejshëm të tij. Praktika e punës në këtë drejtim zhvillohet në bashkëpunim me NJZHKC në përfundim të vitit akademik kur realizohet një pyetësor me studentët, i cili synon të sigurojë informacione të përpunuara dhe reale për qasjet, perceptimet dhe qëndrimet e studentëve në atë se çfarë ata po studiojnë dhe përmirësimet që ata do të dëshironin të kishin.</p> <p>Në kuadër të identifikimit të nevojave për përmirësim dhe për një kurrikul sa më të arrirë, departamenti bashkëpunon me partnerët e jashtëm<sup>49</sup>, pjesë e “Barleti Partners Group”, me të cilët ka marrëveshje partneriteti dhe realizon leksione të hapura me studentët, për orientimin në tregun e punës dhe zhvillimin e praktikës profesionale. Leksione të tilla janë:  <a href="http://umb.edu.al/kerkimi-institute-dhe-qendra-umb.html">http://umb.edu.al/kerkimi-institute-dhe-qendra-umb.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB, studentët kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e studentëve për përmirësimin e programeve të studimeve. Gjithashtu, në UniBa organizohet çdo vit një proces anketimi<sup>50</sup> në të cilin merren mendimet e tyre në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.<sup>51</sup></p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni, drejtuesi i Njësisë Kryesore, drejtuesi i Njësisë Bazë dhe Rektori kryejnë takime të vazhdueshme me</p>

<sup>48</sup> Vendim Bordi i Karrierës (Referuar Evidenca 29)

<sup>49</sup> Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa-se, (Referuar Evidenca 19.5)

<sup>50</sup> Formular i vlerësimit të lëndës nga studentët, (Referuar Evidenca 11.2)

<sup>51</sup> Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa-se, (Referuar Evidenca 19.5)

ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	studentët aktualë dhe ata të diplomuar, formale dhe joformale, lidhur me ecurinë e programit mësimor. Në këto takime shkëmbehen ide dhe bëhen propozime për funksionimin dhe përmirësimin e tij. <sup>52</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti ka në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përditësimin me të rejat e fundit. Për këtë arsye, departamenti ka një rrjet të konsoliduar me bashkëpunorë në fusha të ndryshme, siç është Bordi i Karrierës dhe Urdhri i Punonjësit Social. Sikurse theksohet në Vendimin e Bordit të Karrierës qëllimi i tij është përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti, në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke qenë në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të tjerë të interesuar si studentët, pedagogët dhe partnerë të tjerë të shoqërisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor <sup>53</sup> . Pjesë e veprimtarive mësimore në fushën përkatëse është edhe puna kërkimore <sup>54</sup> , e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit, projekteve të ndryshme dhe përdorimit të literaturës bashkëkohore. Objektivat e programit të studimit janë në rrjedhën e qëllimeve dhe objektiveve të zhvillimit të UniBa-s dhe dy shtyllave kryesore të zhvillimit:

<sup>52</sup> Raport i punës kërkimore shkencore të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 33)

<sup>53</sup> Raporti i kërkimit shkencor, (Referuar Evidenca 20.1)

<sup>54</sup> Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet, (Referuar Evidenca 20.3)

	<p><b>1. Shtylla akademike</b>, fokusuar në veprimtarinë akademike me anë të kombinimit të shërbimeve arsimore, online me ato të drejtpërdrejta;</p> <p><b>2. Shtylla e studentit në qendër</b>, fokusuar në veprimtarinë studentore dhe komunitare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit<sup>55</sup> si njësi kryesore për vetë natyrën e tij zhvillon shumë aktivitete të karakterit artistik dhe rekreativ por edhe të natyrave të tjera që kanë të bëjnë me mësim-dhënien dhe kërkimin shkencor dhe Departamenti nxit anëtarët e saj të marrin pjesë në këto aktivitete, veçanërisht në leksione të hapura apo projekte kërkimore me karakter aplikative.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>UniBa dhe departamenti i nxit studentët të jenë pjesë e trajnimeve dhe e projekteve të ndryshme që organizon institucioni.</p> <p>Brenda universitetit janë krijuar disa klube studentore, si: klubi i sipërmarrësit, klubi i karrierës, klubi i psikologjisë, i arkitektit etj. Në të marrin pjesë studentë, të cilët kanë një ide biznesi dhe kanë dëshirë të ndjekin aktivitete dhe trajnimet e nevojshme në lidhje me startup-et dhe sipërmarrjen.</p> <p>Klubi zhvillon aktivitete periodike, të cilat kanë për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të motivojnë sipërmarrësit e rinj;</li> <li>- të shkëmbejnë ide;</li> <li>- të strukturojnë idenë e tyre;</li> <li>- të punojnë mbi një plan biznesi;</li> <li>- të prezantojnë idenë përpara një jurie, sipërmarrësve potencial të nisin një biznes;</li> <li>- të propozojnë zgjidhje për probleme që shtrohen nga institucione partnere të universitetit (case study) etj.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve me karakter kërkimor njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në UniBa administrimi i të ardhurave nga aktivitetet apo projekteve kërkimore realizohet në nivel institucional. Administratori i UniBa drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit<sup>56</sup> dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kërkimi shkencor në UniBa funksionon në bazë të Rregullores së mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor.</i></p>

<sup>55</sup> Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare (Referuar Evidenca 6)

<sup>56</sup> Plani financiar i programit të studimit 22-23 dhe 23-24, (Referuar Evidenca 43, Tabela18)



	<p><i>Departamenti mbulon një pjesë të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti.</i></p> <p><i>Rekomandohet që UniBa të parashikojë rritjen e buxhetit në “Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore”, “për kërkimin shkencor bazë”, “për veprimtaritë shkencore” si edhe “për botime me faktor impakti”.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Nga vizitat në institucion rezulton se UniBa, një nga shtyllat e veprimtarisë së saj ia ka dedikuar punës kërkimore shkencore. Koordinator i për Kërkim dhe Inovacion (KKI)<sup>57</sup>, nën drejtimin dhe orientimin e Zëvendës Rektorit për Kërkimin e Aplikuar dhe Inovacionin, krijon lidhjen ndërmjet Departamenteve dhe strukturave të kërkimit të aplikuar të Grupit Barleti dhe koordinon zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si hartimin e strategjive, raportet, monitorimi dhe analizat, procedura, vlerësime etj., dhe aktivitetet si Konferenca dhe Botime, Evente, Projekte dhe Programe, Partneritet Ndërkombëtar dhe Promovim<sup>58</sup>.</p> <p>Institucioni ka ngritur njësinë “BRIDGE” (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), që ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, Institutet, dhe organizatat jo-fitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka themeluar institutet dhe qendrat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Instituti i Kërkim Zhvillimit “Barleti” IKZHB (BIRD)</li> <li>- Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike ISHÇP (AIPA)</li> <li>- Instituti i Edukimit “Barleti” IEB (BEI)</li> <li>- Instituti ADRIAPOL Kërkim, Zhvillim, Rritje, Inovacion</li> <li>- Qendra YOUTH ACT</li> <li>- Qendra Education in United States “EDUSA“</li> </ul>

<sup>57</sup> Raporti i kërkimit shkencor, (Referuar Evidenca 20.1)

<sup>58</sup> Raporti i punës vjetore të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 28)



studentët për realizimin e këtyre objektivave.	
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar ka realizuar leksione të hapura dhe seminare për zhvillime të reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë. Në këtë drejtim ai zhvillon “open innovation” në lidhjet e tij të ngushta me institucionet arsimore dhe OJF-të. UniBa ka zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor si element të rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies. Të ftuarit kanë qenë nga shumë fusha dhe me të mirënjohur për ekspertizën apo eksperiencën e tyre. <a href="https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-uniba.html">https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-uniba.html</a>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Sipas RVB, Programi i studimit qëndron në koherencë dhe ndjek zhvillimet e fundit kërkimore dhe shkencore rajonale dhe kombëtare. Institucioni ka ngritur njësinë “BRIDGE” (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), që ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit	Programi i studimit është në përputhje me aktet ligjore vendore dhe rekomandimet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Këto përfshijnë, për shembull, "Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU" (Direktiva për Kualifikimet Profesionale, 2005/36/EU). Programi i studimit <sup>59</sup> formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës si profesion i rregulluar me LIGJ Nr.

<sup>59</sup> Ligji I Urdhrit te Punonjesit Social, (Referuar Evidenca 25)

Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	163/2014 PËR URDHRIN E PUNONJËSVE SOCIALË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit është një program bashkëkohor. Institucioni ka ngritur njësinë "BRIDGE" (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), e cila ka për qëllim të nxisë, mundësojë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, institutet dhe organizatat jofitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Sipas RVB, në Rregulloren e Departamentit <sup>60</sup> përcaktohet se çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje, në mënyrat si më poshtë në: 1. orë leksionesh; 2. orë seminarësh; 3. orë mësimi të integruara: leksione me seminarat; 4. orë ushtrimësh; 5. orë laboratorësh; 6. projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup;

<sup>60</sup> Rregullorja e programit Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor (Referuar Evidenca 3)

	<p>7. provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare;</p> <p>8. forma të praktikës profesionale të zhvilluara në auditor;</p> <p>9. forma të praktikës profesionale të zhvilluar në laboratorë dhe/ose institucione/kompani me të cilat Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi.;</p> <p>10. çdo formë tjetër të miratuar nga njësia kryesore.</p> <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion, por edhe në bisedat me pedagogë dhe studentë, rezultoi se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Referuar Rregullores së Departamentit<sup>61</sup> të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, si dhe nga vizita në institucion dhe takimet e realizuara me personelin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues të RVB-së, u konstatua se gjatë zhvillimit të programit të studimit mësimdhënja realizohet në një formë inovative përmes zhvillimit të moduleve dinamike dhe të mirëorganizuara, të cilat inkurajojnë mendimin dhe punën e pavarur.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB<sup>62</sup> dhe që lidhet me performancën e stafit akademik, kryesisht nisur nga mobiliteti i personelit akademik dhe nga përmbajtja e CV-ve<sup>63</sup> të personelit akademik të paraqitura, konstatohet se personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Siç edhe përmendet në RVB, organizimi i konferencave dhe seminareve shkencore<sup>64</sup> në partneritet me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit, ka krijuar mundësi që personeli akademik të shkëmbejë përvojë, mendime dhe literaturë në fushat e tyre të ekspertizës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies</p>	<p>Rezultoni nga krahasimi i CV-ve<sup>65</sup> të personelit akademik të Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional me llojin e lëndës që zhvillon çdo PAE dhe PAK, se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo PAE/PAK e zhvillon</p>

<sup>61</sup> Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit (Referuar Evidenca 1.2)

<sup>62</sup> Raporti i kerkimit shkencor, (Referuar Evidenca 21.1)

<sup>63</sup> CV e stafit akademik, (Referuar Evidenca 32)

<sup>64</sup> Raport i punës kërkimore shkencore të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 33)

<sup>65</sup>[Evidenca 7.2. CV e Stafit Akademik 2021-2023]]gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Rezulton nga krahasimi i CV-ve<sup>66</sup> të personelit akademik të Departamentit, me llojin e lëndës që zhvillon çdo PAE dhe PAK, se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo PAE/PAK e zhvillon mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë. Kodi i Etikës i UniBa-së i miratuar vite më parë, ka vendosur mënyra të detyrueshme sjelljeje nga personeli akademik, e parashikuar kjo në nenin 4 të kodit, si kundrejt njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt studentëve, shkelja e të cilave pas sjell pasoja për të gjitha palët e përfshira.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për të plotësuar kërkesat ligjore, UniBa-ja ka miratuar Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë,<sup>67</sup> e cila synon të përcaktojë funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në UniBa. Rregullorja<sup>68</sup> ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja përcakton se në nivel fakulteti, përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: 1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti);</p>

<sup>66</sup> Formular i Raportimit të Punës Semestrale staf akademik, (Referuar Evidenca 49)

<sup>67</sup> Rregullore e funksionimit të komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë në Universitetin Barleti, (Referuar Evidenca 16)

<sup>68</sup> Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë, (Referuar Evidenca 16.1)

përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>2. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.MSc.);</p> <p>Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.MSc.)</p> <p>Rezultatet e vlerësimit i shërbejnë institucionit si matës i performancës me qëllim rritjen e kapaciteteve të personelit akademik për mësimdhënien në auditor. Trajnimet e vazhdueshme, leksionet e hapura, prezantimet nga pedagogë dhe promovimi i praktikave më të mira janë forma të përdorura në UniBa për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>UniBa ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme bashkëkohore të mësimdhënies<sup>69</sup> lidhur me hartimin e programeve lëndore, metodat e mësimdhënies, përzgjedhjen e literaturës, sistemin e kontrollit dhe vlerësimin e dijeve të studentëve, këshillimin akademik dhe tutoriatin etj.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Rezultoni se personeli akademik, i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Personeli akademik përdor forma të larmishme të mësimdhënies, të të nxënit, si edhe të transmetimit të dijeve. Këto forma i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga një personel akademik që zhvillon ato lëndë mësimore që janë në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<p><b>Standardi III.2</b> Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të</p>	<p>Për Programin e Studimit MSH Punë Sociale në Sistemin Arsimit kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve tregohen në nenin 88 të rregullores së Universitetit Barleti,<sup>70</sup> si dhe Rregullores së Programit MSH Punë Sociale në Sistemin Arsimit”. Rregullorja e programit të studimit është publike dhe studentët njihen me të prej momentit të fillimit të studimeve.</p>

<sup>69</sup> Udhëzues për metodat e mësimdhënies, (Referuar Evidenca 11,1)

<sup>70</sup> Rregullore e Universitetit Barleti, Nëntor 2022, (Referuar Evidenca 1.3)



<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe stafi akademik, u konstatua se studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore në nga lektori/rja e lëndës dhe në fillim të çdo lënde, sipas përmbajtjes së syllabusit të lëndës/modulit që në orën e parë të procesit mësimor.</p> <p>Studentëve më pas, ju shpërndahe edhe syllbusi i lëndës kryesisht nëpërmjet formës së komunikimit me email individual. Informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë janë në zbatim të Rregullores së UniBa-s<sup>71</sup>, Rregullores së Departamentit<sup>72</sup> dhe Rregullores së Programit<sup>73</sup> MSH Punë Sociale në Sistemin Arsimor”, në të cilën tregohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ lloji i lëndës/modulit;</li> <li>○ totali i krediteve (ECTS);</li> <li>○ emri i lektorit;</li> <li>○ qëllimi i modulit;</li> <li>○ rezultatet e të nxënit;</li> <li>○ literatura bazë dhe ajo e rekomanduar;</li> <li>○ metodologjia e mësimdhënies;</li> <li>○ mënyra e vlerësimit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format e kontrollit të dijes të përcaktura specifiku në frekuentimin, komponentët e kontrollit të vazhdueshëm dhe vlerësimit e lëndës, janë të parashikuara në seksionin përkatës në fund të syllabusit të çdo lënde<sup>74</sup>.</p> <p>Mënyrat e ndryshme të testimit dhe të vlerësimit të njohurive tregohen në Rregulloren e Programit të Studimit<sup>75</sup> ku përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar;</li> <li>○ Me detyra kursi ose projekte;</li> <li>○ Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime.</li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për vlerësimin e studentëve, përdoren kritere të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët. Departamenti inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</i></p>

<sup>71</sup> po aty

<sup>72</sup> Rregullore e Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit, (Referuar Evidenca 1.2)

<sup>73</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

<sup>74</sup> Evidenca 2.2 Syllabuset e lendeve\_Msc. Klinike.pdf

<sup>75</sup> po aty



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar syllabuseve <sup>76</sup> rezultojnë se vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e lëndës, përbëjnë 50 % të vlerësimit total të studentit.</li> <li>2. Vlerësimi përfundimtar në sezonin përkatës, përbën 50 % të vlerësimit total të studentit. Përcaktimi i raporteve të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar është përcaktuar në rang institucioni.</li> </ol> <p>Provimi përfundimtar është detyrim pavarësisht rezultateve të marra gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmanjin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UniBa disponon një sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe sisteme të tjera të koordinuara mirë mes tyre, si për menaxhimin administrativ edhe për pjesën akademike. Ekzistojnë platforma e menaxhimit të studentëve siç është ajo e portalit studentor, platforma LMS e Classroom <sup>77</sup> . Portalit studentor, një sistem në përdorim nga studentët ju mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike, informacion mbi lektorët dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Provimet përfundimtare me shkrim bëhen të sekretuara. Sekretimi i tyre bëhet nga sekretaria
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar Rregullores së programit të studimit <sup>78</sup> rezultojnë se mënyra e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve, por edhe vlerësimi përfundimtar i studentëve, bëhet siç është përcaktuar në çdo program lëndor dhe që është bërë publike përpara fillimit të vitit akademik. <p>Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Hartimi i testit përmbledhës<sup>79</sup> miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Fleta e vlerësimit firmoset nga dekani dhe</p>

<sup>76</sup> Syllabuset e lëndëve, (Referuar Evidenca 2.2)

<sup>77</sup> Udhëzues për përdorimin e strukturës TIK, (Referuar Evidenca 35)

<sup>78</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimit, (Referuar Evidenca 3)

<sup>79</sup> Model teze, (Referuar Evidenca 34)

	<p>kryesekretari.</p> <p>Studenti mund të ankohet me shkrim për notën në modulim/lëndën në afat prej dy (2) ditësh nga data e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës, por para shënimit të notës në regjistrin e arritjeve akademike. Ankesa i drejtohet dekanit dhe më pas dekani ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj.). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si edhe nga takimet me personelin akademik dhe me studentë u konstatua se pedagogët e lëndëve që përfshihen në zhvillimin e Programit të Studimit në mënyrë të vazhduar përgjatë gjithë vitit shkollor, u japin komente studentëve, me shkrim ose me gojë, për çdo etapë të vlerësimit të vazhduar (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, projekt, ese).</p> <p>Sipas RVB, për zhvillimin e testit përmbledhës zhvillohen paraprakisht seanca sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, zhvillohet me ta model testi final, bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit. Të gjitha këto synojnë që studentin të përmirësohet në performancën që do të paraqesë dhe të jetë i vetëdijshëm për vlerësimin.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Salla e provimit monitorohet nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të lëndës, koordinatoreve që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse. Konsiderohen shkelje të rregullave të UniBa-s të gjitha veprimet e kryera me dashje nga studentin, përfshirë ato që përbëjnë cenim të normave shoqërore dhe etiko-morale, si: kopjimi, plagjiatura a paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri; dhënia ose marrja e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit. Ndaj studentit që kryen veprime të tilla merren masa disiplinore sipas rastit: vërejtje me shkrim, përjashtim për një vit nga UniBa, përjashtim përgjithmonë nga UniBa.<sup>80</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas</p>	<p>Vlerësimet e studentëve dokumentohen në fletën e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo</p>

<sup>80</sup> Kodi i Etikës, (Referuar Evidenca 1.5)

përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe kryesekretarja <sup>81</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në takimin pas realizimit të provimit, pedagogu i modulit deklaron rezultatin e provimit të studentët dhe pas dakordësisë, i regjistron të njëjtat në fletën e vlerësimit, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve të njihen paraprakisht me notat e vendosura. Në rast se studenti mendon se ka pasur gabim në llogaritjen e pikëve dhe të notës, ose gjatë shënimit të notës, ka të drejtë të kontaktojë pedagogun e modulit dhe të diskutojnë për vlerësimin. Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet në sistem.			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas nenit 90 të Rregullores së Universitetit <sup>82</sup> , studenti ka të drejtën e ankimimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjegje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i paqarqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të modulit/lëndës, por para shënimit të notës në Regjistrin e Arritjeve Akademike. Përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin, i cili brenda 48 orësh ngre një komision <i>ad hoc</i> për shqyrtimin e ankesës. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e tij me komisionin e miratuar nga dekanin. Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe sekretarinë u konstatua që aktualisht, mënyra e komunikimit të vlerësimit bëhet drejtëpërdrejtë nëpërmjet sekretarisë dhe/ose nga lektori/ria e lëndës gojarisht ose nëpërmjet emilit personal të studentit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Rezultoni se në UniBa, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të programit të studimit testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përmes formave të larmishme. Provimi përfundimtar zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu, studentët kanë të drejtën e njohjes me vlerësimin dhe të drejtën e ankimimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>81</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

<sup>82</sup> Rregullorja e Universitetit Barleti, Nëntor 22, (Referuar Evidenca 1.3)

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Rezulton se programi i studimit Master i Shkencave Shkencor në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”, është organizuar në mënyrë të tillë që të garantojë formimin akademik të specialistëve punonjës social në sistemin arsimor, të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë shqiptare në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore dhe për të kontribuar në përparimin e njohurive dhe praktikave në fushën e profesionit të punonjësit social.</p> <p>Lëndët karakterizuese të kategorisë B që ofrohen në këtë program studimi, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me veçoritë e tij dhe i japin studentëve një formim specifik sipas karakteristikave të tij.</p> <p>Është një ndër objektivat e këtij programi studimi përgatitja e studentëve për të zotëruar njohuritë në shkencën e punës sociale si në aspektin teorik ashtu edhe atë të zbatimit praktik si edhe të aftësojë studentët për të formuar sjellje etike dhe profesionale gjatë punës me target grupe të ndryshme klientësh si nxënës, mësues, familje të nxënësve, grupe dhe komunitete etj</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Sipas bisedave me stafin akademik dhe RVB-së, ky program studimi UniBa ka disa manuale dhe guida për mësimdhënien online, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Manual i mësimdhënies online,</li> <li>2) Manual për përdorimin e Google classroom (për pedagogët dhe studentët),</li> <li>3) Manuali i përdorimit të GSuit,</li> <li>4) Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit,</li> <li>5) Guidë instruktive e mësimi online, në mënyrë që procesi i mësimi online të zhvillohej sa më lehtë dhe në mënyrë eficiente.</li> </ol>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të cilat janë të pasqyruara në objektivat e vendosura në syllabuset e lëndës, evidentohen në rradhë të parë në rezultatet e tyre në format e ndryshme të testimit përgjatë vitit dhe në provimet përfundimtare. Provimet<sup>83</sup> dhe format e tjera të testimit pasqyrojnë njohuritë immediate të përfitimit të njohurive.</p> <p>Personeli akademik i Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit i cili planifikon udhëheqësit e temave të diplomave te</p>

<sup>83</sup> Paketa e provës finale, (Referuar Evidenca 13.3)





rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e temave të diplomave duke komunikuar me studentët me anë të postës elektronike ose takimeve të drejtpërdrejta konsultuese.
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion zhvilloi dhe bisedat me studentët e programit të studimit, ku u konstatua se mësimdhënia që zhvillohet në këtë departament, bazohet në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe qëndrimeve të studentëve, duke u ofruar atyre mundësi për zhvillimin e njohurive që lidhen si me përgatitjen e tyre shkencore, ashtu dhe me përgatitjen pedagogjike. Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në të gjitha lëndët, pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve krijuese dhe mendimin kritik e shkencor të studentëve. Stafi inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre në mësimdhënie e të nxënë. Edhe departamentet i krijojnë pedagogëve dhe studentëve mundësi për përfshirje në projekte kërkimore, studime të avancuara, <i>bootcamps</i> nëpërmjet instituteve dhe qendrave të Grupit "Barleti". <b>Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Rezulton se stafi akademik realizon diskutime për ndarjen e përvojave më të mira dhe për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të fituara përmes mobilitetit të stafit në universitete të tjera evropiane, pjesë e programit Erasmus+. <sup>84</sup> Kjo përfshin sesione bashkëbisedimesh, ku personeli akademik ndajnë me njëri-tjetrin me praktikat më të suksesshme dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre të huaja. Ky proces i shkëmbimit të njohurive shërben për të pasuruar ambientin akademik dhe për të siguruar një perspektivë ndërkombëtare në zhvillimin e veprimtarive të universitetit <sup>85</sup> .
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. UniBa mbështet idetë bashkëkohore të studentëve dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte kërkimore e studime të avancuara nëpërmjet instituteve "UniBa".

<sup>84</sup> Të dhëna mbi marrëveshjet e bashkëpunimit mbi mobilitetin e stafit dhe marrëveshjet në kuadër të projektit Erasmus +, (Referuar Evidenca 10.2)

<sup>85</sup> Listë e aktiviteteve të departamentit 22-23, (Referuar Evidenca 31)



	Përmes mbështetjes financiare, institucioni shfaq përkushtim ndaj zhvillimit të njohurive dhe ideve inovative të studentëve, krijuan një mjedis të stimulueshëm për rritjen e dijes dhe krijimin e një komuniteti akademik të pasur dhe të përfshirë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Zbatimi i Planit Mësimor, parashikon zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme me natyrë teknologjike/ pedagogjike/ gjuhësore /komunikuese. Këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndëve të ndryshme dhe programit të studimit. Komunikimi mbi vlerësimet bëhet në përputhje me rregullat e privatësisë dhe të drejtat e studentëve për t'u informuar dhe për të kërkuar rishikimin e rezultateve të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” <sup>86</sup> , përcakton: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. modalitetet që ndiqen për të zgjedhur midis punimit të diplomës apo provimit përfundimtar;</li> <li>2. modalitetet për t'u regjistruar për provim diplome;</li> <li>3. përgatitja dhe vlerësimi i tezës së diplomës;</li> <li>4. mbrojtja e tezës së diplomës;</li> <li>5. organizimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës;</li> <li>6. mënyra e pajisjes me diplomën përkatëse, pasi studenti përmbush të gjitha detyrimet akademike.</li> </ol> <p>Për të fituar diplomën Master Master i Shkencave” në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor në dy vite akademike, studenti duhet të japë provën finale, e cila mund të jetë një tezë kërkimi, një seri esesh, një projekt kërkimi, një dosje kërkimi, por mund ta përfundojë dhe me provim final.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Personeli akademik i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” mbështet dhe ndihmon studentët, duke iu dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime

<sup>86</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të detyrimeve përmbyllëse. <sup>87</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për të fituar diplomën Master i Shkencave në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, përveç arritjes së rezultateve pozitive përgjatë kursit dhe kryerjes së praktikës, studentët duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale e cila është në trajtën e punimit të diplomës. Departamenti propozon komisionet të cilat duhet të jenë me jo më pak se tre anëtarë nga departamenti. Komisioni miratohet nga Dekani i Fakultetit. <sup>88</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës <sup>89</sup> (i përcaktuar nga Komiteti Shkencor i programit) i ofron studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme për të arritur standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, të bëjë kritikën e duhur për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pedagogu udhëheqës i studentit që provën finale e ka me temë diplome asiston dhe udhëzon atë gjatë gjithë procesit të kërkimit. Në varësi të temës dhe fushës së studimit institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit si brenda institucionit, në njësitë e grupit "Barleti", si edhe jashtë tij në institucionet partnere.
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes	Siç e parashikon edhe Rregullorja e Programit të studimit <sup>90</sup> , mbështetur në procedurën e diplomimit dhe programin mësimor studentit në provimin final vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara.

<sup>87</sup> Paketa e provës finale, (Referuar Evidenca 13.3)

<sup>88</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

<sup>89</sup> Paketa e provës finale, (Referuar Evidenca 13.3)

<sup>90</sup> Rregullore e programit MSH në Punë Sociale në Sistemin Arsimor, (Referuar Evidenca 3)

së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.									
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit me sukses të Programit të Studimit <sup>91</sup> dhe pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare ndaj universitetit, studentit pajiset me Diplomën dhe Suplementin e saj, të miratuara në QSHA. Nëse studentit e kërkohet, atij i vendoset në dispozicion edhe një kopje e plotë e programit mësimor të zhvilluar përgjatë tre viteve.								
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UniBa-ja e përpunon informacionin e krijuar gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe administrative sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Rregulloren për Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UniBa. <sup>92</sup> Çdo student i veçantë, mbi bazën e kërkesës së tij, mund të kërkojë në çdo kohë informacione që lidhen me jetën e tij akademike, brenda kufijve të caktuara në aktet rregullatore të universitetit, si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Në arkivin e UniBa-s ruhet për një periudhë të pacaktuar në sekretari një kopje e dokumentacionit të secilit student.								
<b>Konkluzione</b>	<i>Në përfundim të studimeve, parashikohen rregulla shumë të qarta për mënyrën e përgatitjes, zhvillimit, si edhe të vlerësimit të tezës së diplomës. Pas zhvillimit të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë dhe pajiset me Diplomë dhe Suplementin e saj. Vlerësimi i punimit të provës finale duhet të specifikojë më qartësisht faktin që realizohet me notë. Pas përfundimit të studimeve, studentit do të pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, duke reflektuar nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th><b>Përmbushet pjesërisht</b></th> <th><b>Përmbushet kryesisht</b></th> <th><b>Përmbushet plotësisht</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

### Standardi III.6

<sup>92</sup> Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore, (Referuar Evidenca 18)

**Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Gjatë zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Pune Sociale në Sistemin Arsimor, për vlerësimin e studentëve, përdoren kriteret e qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimin të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimin të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
---	--	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>																						
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>																						
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																					
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” që mbulon Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shendetit përmbush kriteret ligjore dhe ka nivelin e duhur të kualifikimit për drejtimin e programit të nivelit të dytë.</p> <p>Për vitin akademik 2023-2024 numri total i pedagogëve që japin mësim në programin e studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” është 11 (3 janë me titullin “Profesor i asociuar”, 7 me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 me gradën Msc. Raporti mes stafit akademik PAE me PAK është si më poshtë: <sup>93</sup></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Stafi akademik i prgramit MSHPPSA</th> <th>2023-2024 PAE / PAK</th> <th>2022-2023 PAE / PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.</td> <td>0 / 0</td> <td>0 / 0</td> </tr> <tr> <td>Prof.asociuar</td> <td>2 / 1</td> <td>1 / 0</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>3 / 4</td> <td>2 / 2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>0/1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsejt</b></td> <td><b>5 / 6</b></td> <td><b>3 / 2</b></td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>11</b></td> <td><b>5</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Nënvizojmë se viti akademik 2022-2023 është viti i parë i hapjes dhe ka vetëm vitin e parë, ndërsa viti 2023-2024 në tabelën nr.12 ka disa pasaktësi, ku pedagogu në një lëndë është PAK dhe në një lëndë tjetër me poshte PAE.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve që mbulojnë dhe fushave të studimit rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve që mbulojnë këtë program</p>	Stafi akademik i prgramit MSHPPSA	2023-2024 PAE / PAK	2022-2023 PAE / PAK	Prof.	0 / 0	0 / 0	Prof.asociuar	2 / 1	1 / 0	Dr	3 / 4	2 / 2	Msc	0/1	-	<b>Gjithsejt</b>	<b>5 / 6</b>	<b>3 / 2</b>	<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>5</b>
	Stafi akademik i prgramit MSHPPSA	2023-2024 PAE / PAK	2022-2023 PAE / PAK																			
Prof.	0 / 0	0 / 0																				
Prof.asociuar	2 / 1	1 / 0																				
Dr	3 / 4	2 / 2																				
Msc	0/1	-																				
<b>Gjithsejt</b>	<b>5 / 6</b>	<b>3 / 2</b>																				
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>5</b>																				

<sup>93</sup> Tabelë përmbledhëse për aneks të RVB ( Referuar: Tabela 12 )



	studimi, kanë nivelin e duhur të kualifikimit dhe fushat kërkimore të tyre përputhet me programin. <sup>94</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i të dhënave mbi personelin akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” rezulton se stafi akademik efektiv dhe ai nga departamentet e tjera është në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për Veprimtarin dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Statutin e UniBa-së (neni 50; 51). <sup>95</sup> <i>Rezulton se stafi akademik PAE mbulon mbi 70.4 të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi.</i> <sup>96</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analiza e planeve mësimor në tabelat e paraqitura lidhur me pedagogët që japin mësim në programin e studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” konstatohet se stafi akademik që mbulon ngarkesën e këtij programi nuk ka patur qëndryeshmëri, pasi janë ndryshuar në vitin akademik 2023-2024 nga 12 pedagogë që mbulojnë programin 6 prej tyre. <i>Në takimin me drejtues të fakultetit u tha se largimi i pedagogëve është bërë nga vetë pedagogët për arsye individuale, duke u punësuar në një institucion tjetër.</i> Në zyrën e burimeve njerëzore për të gjithë stafin si PAE ashtu dhe PAK kishte kontrata dhe deklarohet që paguheshin sigurimet shoqërore. <sup>97</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në Statutin e institucionit UniBa ( neni 51;53;54 ) dhe rregulloren e IAL-së (neni 55) si dhe dokumentacionit që disponon Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit dhe Burimet njerëzore rezulton se janë të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe atij më kohë të pjesshme. Bazuar në këto dokumenta Departamenti mund të vendosë kritere specifike në përshtatje me kërkesat që ka për pedagogun që do të rekrutojë, kritere që miratohen më pas nga Rektori <sup>98</sup> Në takimin me njësinë e Burimeve njerëzore u konstatua se në rekrutimin e stafit të ri ndiqen të gjitha procedurat e përcaktuara në rregullore, duke filluar nga përcaktimi i kritereve të përgjithshme dhe specifike, shpallja ne APP, ngritja e komisionit të vlerësimit, shqyrtimi i dosjes dhe intervista, të gjitha transparente publikuar në faqen zyrtare <sup>99</sup>

<sup>94</sup> Syllabuset e programit të studimit Master i Shkencave PSSA ( Referuar : Evidenca Nr.1.4 ; 2.2;)

<sup>95</sup> Statuti i UniBa-s ( Referuar: Evidenca nr 1.4 )

<sup>96</sup> Tabelë përmbledhëse për aneks të RVB ( Referuar: Tabela 12 )

<sup>97</sup> Syllabuset e MSC PSSA ( Referuar: Evidenca Nr. 1.4 dhe 2.2 )

<sup>98</sup> Statuti dhe Rregullorja e UniBA. ( Ref: Evidenca 1.4 dhe 1.3 )

<sup>99</sup> Manuali i Burimeve njerëzore. ( Ref: Evidenca 7.1 )

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në raport flitet për mjedise bashkohore që ka institucioni dhe Fakulteti i Shkencave sociale turizmit dhe sportit për të siguruar një mësimdhënie sa më cilësore, laboratore të tilla si laboratorit i multimedias, por nuk rezulton se ka laboratore apo mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit, ku ka edhe lëndë si” Praktikë klinike në kontekstin e shkollës me fëmijë dhe familjen” “Këshillim individual dhe në grup” si dhe nuk ka personel ndihmës akademik<sup>100</sup></p> <p><i>Në takimin me stafin u theksua se pavarësisht mungesës së ambienteve specifike për programin, pedagogët improvizonin këto në ambientet ku japnin mësim.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Në takimin me drejtues të Departamentit të Shkencave të sjelljes dhe shëndetit si dhe Degën e Burimeve njerëzore bazuar në verifikimin e dosjeve të personelit akademik dhe jo akademik konfirmojmë që ekziston një bazë të dhënash të detajuara për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, titujt dhe gradat shkencore që kanë ngarkesë mësimore në kuadrin e këtij programi, kualifikimin, punën shkencore të tyre,</p> <p>Të gjitha strukturat përgjegjëse të programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” të UniBa (Fakulteti, Departamenti përkatës, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretaria Mësimore,) bazuar në detyrat e përcaktuara në rregullore disponojnë listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në këtë program për çdo vit akademik dhe kanë informacion të plotë për realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse.<sup>101 102</sup></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit rezulton se ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucione dhe organizatash për realizimin e praktikave profesionale të studentëve<sup>103</sup>.</p> <p>Njësia kryesore e Fakultetit përgjegjëse e programit të studimit Departamenti i Shkencave të sjelljes dhe shëndetit ka edhe një paketë të praktikës profesionale ku pasqyrohet qëllimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve.<sup>104</sup></p> <p>Në rregulloren e studimit të Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ( neni 98;99;100,) si dhe në paketën e mbrojtjes finale janë të përcaktuara qartë detyrat e strukturave</p>

<sup>100</sup>Mjediset për FSHSTS ( Ref. Evidenca Nr. 40.2 )

<sup>101</sup> Manuali i Burimeve njerëzore. ( Ref: Evidenca 7.1 )

<sup>102</sup> Rregullore e IAL UniBa ( Ref: Evidenca Nr. 1.3 )

<sup>103</sup> Tabela përmbledhëse në RVB ( Tabela Nr. 5)

<sup>104</sup> Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi UniBa ( Ref: Evidenca Nr. 21.1 )

diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	dhe personelit akademik lidhur me detyrimet mbyllëse të studentëve që ndjekin këtë program studimi. <sup>105</sup>								
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ka edhe një paketë të praktikës profesionale ku pasqyrohet qëllimi objektivat dhe mënyra e vlerësimit të studentëve, përgjegjësitë e personelit lidhur me realizimin dhe vlerësimin e studentëve. <sup>106</sup>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mendon se Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit dhe në veçanti Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit që mbulon këtë program studimi ka personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë, i cili përmbush standardet ligjore dhe akademike në përputhje me fushën e programit. Standarti përmbushet plotësisht</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" ka një infrastrukturë të mjaftueshme që përfshin ambiente për Leksione dhe Seminare në dy kampuse, atë në rrugën e Kosovarve me sipërfaqe 2347 m <sup>2</sup> dhe kampusi në rrugën Fran Bardhi në Selitë ku zhvillohet programi me sipërfaqe 6451 m <sup>2</sup> , që i plotësojnë kriteret, dhe sigurojnë një mësim normal të këtij programi studimi, bazuar edhe në numrin në ulje të studentëve. Janë 6 auditore për leksione, 3 salla për praktikë lëndore, 2 laboratore informatike dhe 2 salla biblioteke. Në dispozicion është edhe një sallë për aktivitete promovuese me 140 m <sup>2</sup> për organizimin edhe të konferencave të ndryshme.

<sup>105</sup> Paketa e mbrojtjes finale ( Ref: Evidenca Nr.13.3 )

<sup>106</sup> Paketa e praktikës profesionale ( Ref: Evidenca Nr.13.2 )

	<p>Stafi akademik si edhe ai administrativ është i sistemuar në 3 zyra me sipërfaqe 183 m<sup>2</sup> të cilat janë instaluar pajisjet e nevojshme për një funksionim normal të punës. <sup>107</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit i UniBA-s në ambientet në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor" si edhe u konstatua nga vizita në institucion, kishte mjedise mësimore si auditore, salla mësimi të paisura me mjete elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit, në mënyrë të veçantë të teknologjisë bashkohore në fushën e mësimdhënies. Tërë ambietet mbulohen me internet me rrjetin wifi <sup>108</sup>,</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në UniBa ka mjedise të mjaftueshme dhe të paisura me aparatura dhe mjetet e nevojshme didaktike dhe teknologjike të cilat janë në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" në përputhje me kërkesat e lëndëve për një formim teorik dhe praktik të studentëve, përcaktuar në qëllimet e programit. <sup>109</sup></p> <p><i>Rezulton se nuk ka ambiente apo salla për lëndët "Këshillim individual dhe në grup" "Praktikë klinike në kontekstin e shkollës me fëmijë dhe familjen"; " Këshillim karriere" etj. Mendojmë se për një formim profesional më të mirë të studentëve për programin në fjalë, departamenti duhet të krijojë ambiente specifike për këshillim.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program studimi të ngrrejë mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit për lëndët e përmendura më sipër, të paisura me infrastrukturën fizike dhe njerëzore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga verifikimi i evidencave të paraqitura në RVB, rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, në korpusin e ri ka në funksion të programit Master i Shkencave në " Puna Sociale në Sistemin Arsimor" dy laborator të informatikës i paisur me kompjutera, laptop, projektore etj, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë të</p>

<sup>107</sup> Mjediset për FSHSTS ( Ref. Evidenca Nr. 40.2 )

<sup>108</sup> Relacion për I infrastrukturën në funksion të programit (Ref. Evidenca Nr. 40.3)

<sup>109</sup> Relacion për I infrastrukturën në funksion të programit (Ref. Evidenca Nr. 40.3)



	mësimdhënies e mësimxënies si dhe për aftësimin teorik dhe praktik në përputhje me objektivat e programit. <sup>110</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Konfirmojmë se UniBa ka në dispozicion të programit të studimit mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale me studentë, në godinat që zotëron ose në institucionet me të cilat ka marrëveshje për realizimin e praktikës profesionale të studentëve.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ arrin në konkluzionin se institucioni ka mjaftueshëm mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin teorik dhe praktik sipas objektivave formuese të programit të studimit, por duhet të mendojë edhe për ambientet specifike që kërkon natyra e këtij program studimi (Kriteri 3.)</i> <i>Konstatohet se standarti përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit	Nga shqyrtimi programeve lëndore të programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” janë përcaktuar si elementë edhe literatura bazë dhe e rekomanduar që u ofrohet studentëve qoftë fizike ashtu edhe digjitale (literaturë e

<sup>110</sup> Relacion për infrastrukturën në funksion të programit (Ref: Evidenca Nr. 40.3)



<p>(fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>cila gjindet në bibliotekën e UniBa-s fizikisht dhe online siguron marrjen e njohurive të domosdoshme për një formim profesional të studentëve). <sup>111</sup>  <i>Nisur nga niveli i dytë i studimeve mendojmë se literatura në syllabuse duhet të jetë më e madhe në numrin e librave që rekomandohen si në atë bazë të detyruar ashtu edhe në atë të rekomanduar.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit si edhe konstatohet nga vizita në institucion bën një përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e literaturës me botime të reja nepërmjet përcaktimit të një fondi për bibliotekën, bazuar në kërkesat e Departamentit të Shkencave të sjelljes dhe shendetit. Nga ana tjetër edhe biblioteka ka një plan strategjik ku përfshihet edhe detyrimi i pedagogëve për të zgjeruar fondin e saj me çdo botim të tyre të ri. Duhet pranuar se ka një tendencë për të pasuruar literaturën me botime të viteve të fundit, paqyruar kjo në kërkesën e departamentit për libra të rinj, <sup>112</sup> por nga <i>shqyrtimi i evidencave të paraqitura si dhe verifikimit në syllabuse rezulton se literatura e përdorur në shumicën e syllabuseve nuk e kalon vitet 2018, ndaj ka nevojë për përditësim, pasi kemi të bëjmë me Master i Shkencave.</i> <sup>113 114</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka pranë UniBa-s është e përqëndruar në dy kampuse me një sipërfaqe 232.4 m<sup>2</sup>, dhe me 114 poste leximi në shërbim të vazhdueshëm për studentë në çdo ditë të javës.          Biblioteka garanton një shërbim të barabartë për të gjithë studentët e programe të ndryshme studimi, dhe në këtë aspekt edhe programit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” që mbulon ky fakultet. Studentët kanë akses në shërbimet online (Katalogun online dhe Arkivën digjitale) që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit. <sup>115</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të</p>	<p>Nga vizita në bibliotekën e UniBa-s, si dhe nga verifikimi i fondit të librave që disponon kjo bibliotekë, rezulton se në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” është një fond i mjaftueshëm librash në shqip dhe në gjuhë të huaj, dhe që janë në përputhje me materialin bazë të ofruara nga programet e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive mësimore të programuara në to.</p>

<sup>111</sup> Syllabuset e MSC PSSA ( Referuar: Evidenca Nr. 1.4 dhe 2.2 )

<sup>112</sup> Kerkese per tituj te rinj librash cdo fillim viti akademik.( Ref: Evidenca Nr. 46 )

<sup>113</sup> Syllabuset e MSC PSSA, elementi “ Literatura baze dhe e detyruar, dhe ajo e e rekomanduar ( Referuar: Evidenca Nr. 1.4 dhe 2.2 ).

<sup>114</sup> Literaturë e shtuar ( Ref: Evidenca Nr.41 )

<sup>115</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s. <https://umb.edu.al> Rubrika A kademike,Biblioteka.

mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka i jep mundësinë studentëve të shfrytëzojnë edhe fondin periodik, gazeta revista si dhe përdorimin e librarisë elektronike. <sup>116</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës konstatohet se UniBa ka krijuar kushte dhe ka akses të barabartë për studentët për shfrytëzimin e bibliotekave online ku studentët marrin informacion si nga literatura shqipe dhe e huaj si: biblioteka JSTOR me libra dhe burime që përfshin 12 disiplina; EBSCO Open Dissertation; DOAJ (Director of Open Access Journals). <sup>117</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në ambientet e Bibliotekës së UniBa-s rezulton se ka ambiente fizike të mjaftueshme, dhe është mirë e paisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera në shërbim të studentëve. Biblioteka ka të instaluar “Platformën online” që mundëson studentëve marrje informacioni edhe jashtë ambienteve të institucionit. <sup>118</sup>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Në faqen zyrtare të UniBa-s dhe në ambientet e bibliotekës janë të verifikueshme oraret e bibliotekës e cila qëndron e hapur çdo ditë nga ora 8.00 deri 19.45, (nga ora 8.00 deri 16 për shkëmbim librash dhe 16.00 deri 19.45 për studim) <sup>119</sup> Në situata të vecanta provimesh kjo bibliotekë shërben me ditë dhe orare të përshtatshme për studentët.
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online	Biblioteka Universitare UniBa rezulton se ka një bashkëpunim të mirë mes strukturave të institucionit për të garantuar cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës si dhe përditësimin e këtij fondi si dhe nivelin e shfrytëzimit të tij. Biblioteka ka krijuar edhe klubin Books and Tech dhe ka ndërmarrë një sërë aktivitete promovuese për librin. <sup>120</sup> Nga vizita e GVJ si me stafin akademik, me përgjegjësin e departamentit dhe me punonjësit e bibliotekës rezulton se departamenti bën vazhdimisht kërkesë për përditësim literature fizike dhe digjitale.

<sup>116</sup> Relacion për infrastrukturën në funksion të programit (Ref: Evidenca Nr. 40.2 )

<sup>117</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s. <https://umb.edu.al> Rubrika A kademike, Biblioteka

<sup>118</sup> Relacion për infrastrukturën në funksion të programit (Ref: Evidenca Nr. 40.2 )

<sup>119</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> ( Akademia Biblioteka )

<sup>120</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> ( Akademia Biblioteka “Burimet dhe bibliotekat online”)

nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të vënë në dispozicion si literaturë bashkohore për studentët por edhe një mjedis pune në bibliotekë e cila ka siguruar një fond të mjaftueshem librash si fizik dhe në rrugë dixhitale. Mendojme se numri i librave të rekomanduar si literaturë në syllabuse të jetë më shumë, së bashku me përditësimin e literaturës sidomos asaj të rekomanduar duhet të jetë i pranishëm në të disa syllabuse.</i> <i>(kriteri 1; 2)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nëpërmjet një sistemi të menaxhimit UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si njësi përbërëse e saj, administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky sistem përfshin “Zyrën e Rekrutimit Pranimit dhe rregjistrimit”; “Sekretarinë mësimore”, Platforma “Portali studentor” dhe “Google Classroom”, “Sektori i IT” që ofron një sasi aplikacionesh të integruara me njëra tjetrën e cila jep mbështetje të plotë për procedurat e administrimit të dokumentacionit të studentëve nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre <sup>121 122</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin,	Në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si dhe strukturat e tjera ndihmëse si Njësisë të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretarisë mësimore dhe komunikimit, në INTRANET

<sup>121</sup> Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK-ut (Ref: Evidenca Nr. 35.)

<sup>122</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> ( Pranimet “Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Rregjistrimit” )

dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	rezulton se ka një sistem menaxhimi të informacionit, ku administrohet tërë dokumentacioni që lidhet me përditësimin e të dhënave të stafit akademik ndihmës akademik dhe administrativ lidhur me tërë veprimtarinë e tyre në kuadrin e realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" <sup>123</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit pranë FSHSTS si pjesë e veprimtarisë të sistemit të UniBa-s i cili administron të dhëna për studentë dhe staf akademik i bën të aksesueshme nepërmjet faqes zyrtare të institucionit, njësive përkatëse, Intranetit dhe platformave online. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të UniBa-s dhe Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, ku ofrohet programi i studimit MSH PSSA siguron të ketë akses të informacioneve dhe të dokumentave, për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore, e cila vë në dispozicion të tyre si planin mësimor, syllabeset, të dhëna të tjera kur kërkohen kopje fizike e tyre. <sup>124 125</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sipas RVB-së dhe verifikimit në vizitën e bërë në institucion rezulton se përveç takimeve fizikisht pedagog – student institucioni ka ngritur platforma dhe system menaxhimi që mundëson shkëmbim të informacionit ndërmjet pedagogut me studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Bazuar në rregullore të funksionimit dhe vlerësimit të veprimtarisë akademike, Sekretaria mësimore, Njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe cilësisë, monitoron në kohë reale tërë aktivitetin akademik dhe administrativ si dhe publikon në faqen zyrtare rezultatet e kësaj veprimtarie. <sup>126 127</sup>
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në	Nga verifikimi në Faqen zyrtare të UniBa-s -së mund të konfirmojmë se institucioni publikon vazhdimisht informacione për të gjitha fushat e funksionimit në Universtitetin dhe në këtë kuadër edhe të informacionit që lidhet me programin e studimit Master i Shkencave në " Puna Sociale në Sistemin Arsimor"

<sup>123</sup> Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK-ut (Ref: Evidenca Nr. 35.)

<sup>124</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al>

<sup>125</sup> Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref: Evidenca Nr. 13.1 )

<sup>126</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> ( Rubrika Dossier )

<sup>127</sup> Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës. ( Ref: Evidenca Nr. 12.)

faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në këtë faqe zyrtare ka të dhëna për departamentin pedagogët, studentët, urdhëra dhe udhëzime, veprimtari si dhe informacion që lidhet me programin e studimit.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit si pjesë e strukturave të UniBa-s ka një sistem menaxhimi institucional që bën përpjekje për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ të institucionit që lidhet me programin e studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	IAL UniBa harton çdo vit nepërmjet Drejtorisë së Financave një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat lidhur me veprimtarinë akademike dhe shkencore të institucionit, duke përfshirë këtu edhe shpenzimet që lidhen me programet e studimit që ajo ofron. Në këtë aspekt përfshihen edhe mbulimi i programit të studimit të Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit. <sup>128</sup> Gjatë vizitës na u paraqit një plani financiar i institucionit për mbulimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” që ofrohen nga ky fakultet.

<sup>128</sup> Plani financiar I programit të studimit ( Ref: Evidenca nr. 43.)





<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase</p>	<p>UniBa si institucion nëpërmjet Zyrës së financës dhe kordinimit financiar ka një plan financimi për tërë strukturat universitare i cili miratohet në Senatin akademik të institucionit dhe në Bordin e Administrimit.<sup>129</sup></p> <p>Rezulton nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën në UniBa se plani i financimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” i ofruar nga Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit si edhe raportohet në RVB (Evidenca 45) është e vitit 2020, para hapjes së këtij programi.</p> <p>Nga shqyrtimi i buxhetit të institucionit konstatohet se është planifikuar sipas zërave të caktuar në buxhet, mbulimi i kostove për personelin PAE dhe PAK, mirëmbajtje e mjediseve, si dhe shpenzime për bibliotekën online.<sup>130</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në VKM nr 83, date 03.02.2016, auditimit të brendshëm në Sektorin publik, UniBa ka njësi auditimi të brendshëm, por nuk rezulton se ka ndonjë raporte periodike auditimi për institucionin (evidenca 44 nuk është raport auditimi, por të dhëna nga raporti financiar vjetor i universitetit)</p> <p>Auditimi i jashtëm i institucionit realizohet nga kompania “Grand Thorton” dhe raporti është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Qendrës kombëtare të Biznesit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa bën çdo vit një analizë financiare të përgatitur nga Zyra e financës dhe paraqet pranë Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit, raportin për realizimin e buxhetit të vitit sipas zërave përkatës ku përfshihen edhe shpenzimet për mbulimin e programeve të studimit, duke e bërë të aksesueshëm për të gjitha njësitë e institucionit.<sup>131</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Zyrën ekonomike dhe takimi me drejtues të institucionit konfirmojmë se UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” të njësisë bazë Departamentit të Shkencave të Sjelljes dhe Shëndetit” dhe ka kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të gjithë programeve, bazuar në grandin që vjen nga buxheti i shteti, të ardhurat që realizohen nga shërbimet që kryen si dhe të ardhurat që vijnë nga projektet<sup>132 133</sup>.</p>

<sup>129</sup> Burimet financiare të UniBA-s ( Ref: Evidenca Nr.45 )

<sup>130</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al> ( Rubrika Zyra e financës.Detyrat kryesore të Drejtorit të financës )

<sup>131</sup> Raport vjetor I veprimtarisë së UniBa-s. ( Ref: Evidenca Nr.57)

<sup>132</sup> Burimet financiare të UniBA-s ( Ref: Evidenca Nr.45 )

<sup>133</sup> Raport vjetor I veprimtarisë së UniBa-s. ( Ref: Evidenca Nr.57)

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.				
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se UniBa garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e programit të studimit, reflektuar kjo në gjëndjen financiare të institucionit referuar raporteve financiare vjetore.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UniBa si institucion ka ngritur për të gjitha programet e studimit një strukturë e mirëorganizuar për shërbimet studentore si : “Zyra e rekrutimit pranimit dhe regjistrimit”; “Sekretaria mësimore”; Zyra e Alumnit dhe Karrierës” ku janë përcaktuar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve të saja rregullatore një sërë procedurash që lidhen me mbulimin e studentëve nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve. <sup>134</sup> Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me studentë, rezulton se studentët njihen që fillim me kriteret e pranimit dhe të konkurimit nepërmjet publikimit në faqen zyrtare nga ana e institucionit, me planin mësimor dhe kërkesat e programeve të lëndëve, mënyrën e komunikimit dhe të ankimimit, përparimit të tyre etj. <sup>135</sup>

<sup>134</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al> ( Studentët,Pranimet, Karrieraë)

<sup>135</sup> Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve. (Ref: Evidenca Nr. 19.5)

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ndjek procedura transparente për pranimet në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" duke parashikuar kuota për kandidatë të vecantë, nga trojet, pakicat kombëtare, përsona me aftësi të vecantë, duke i publikon në faqen zyrtare të institucionit. Këto procedura të përcaktuara në rregulloret e institucionit dhe njërive të saj, garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit.<sup>136 137</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret e pranimit përzgjedhja e kandidatëve për çdo program studimi hartohet nga institucioni sipas njërive përkatëse dhe publikohet në faqen zyrtare të tij. Pranë institucionit funksionon edhe "Zyra e rekrutimit pranimit dhe rregjistrimit" e cila zbaton rregulloren dhe kriteret e përcaktuara nga institucioni konform legjislacionit në fuqi.<sup>138</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rregulloren e UniBa-s (neni 80-82), në rregulloren e programit të studimit MSH në PSSA janë përcaktuar qartë të gjitha procedurat e pranimit, përparimit të transferimit dhe të vlerësimit të studentëve, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë në faqen zyrtare të institucionit.<sup>139 140</sup> Institucioni ka edhe nje rregullore te transferimit dhe të njohjes së studimeve të mëparshme të studentëve.<sup>141</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit rezulton se cdo vit akademik i bën të ditura studentëve të nivelit Master dhe palëve të tjera të interesuara kriteret e pranimit të përgjithshme dhe të veçanta, informacion mbi organizimin dhe përmbajtjen e Programit Master i Shkencave "Puna Sociale në Sistemin Arsimor".</p>

<sup>136</sup> Ref. Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al>, Rubrika Dossier

<sup>137</sup> Rregullore e institucionit UniBa-s (Ref: Evidenca Nr. 1.3.)

<sup>138</sup> Faqja zyrtare e UniBa <https://umb.edu.al>, (Rubrika Pranimit)

<sup>139</sup> Rregullore e UniBa-s ( Ref: Evidenca.Nr. 1.3 )

<sup>140</sup> Rregullore e MSH në PSSA ( Ref: Evidenca Nr. 3.)

<sup>141</sup> Rregullore e transferimit të studentëve ( Ref: Evidenca Nr. 18.2.)

	Kjo realizohet nepërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit, rrjetet sociale të institucionit, faqes shtetërore dhe portalit U-Albania si dhe fletë palosjeve dhe javës së informimit <sup>142</sup>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Nga dokumentacioni rezulton se UniBa harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret për pranimet në ciklin e parë të studimeve Master në "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" duke filluar me propozimin e njësisë bazë, miratimin në Senatën akademik dhe publikimi edhe në U-Albania të kriterëve dhe kuotave për kandidatë me aftësi të vecantë, pakicave dhe shtresave të marginalizuara, duke i bërë publike në faqen zyrtare të institucionit <sup>143</sup>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në rregulloren e programit të studimit MSH në PSSA neni 24;25;26 konfirmohet se në konkurim mund të marrin pjesë të gjithë studentët që kanë një diplomë bachelor, dhe për studentët jashtë vendit pas ekuivalentimit të diplomës			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën Pranimet (Tarifa dhe Bursa), publikohen të dhëna për kriteret dhe mënyrën e aplikimit nga studentët për përfitim për bursa studimi si dhe për përjashtimin nga tarifa shkollore për ti ardhur në ndihmë studentëve që vinë nga shtresat në nevojë. Në takimin me studentë dhe në sekretarinë mësimore u konfirmua ky fakt <sup>144</sup>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit si dhe harton edhe politika ndihmëse për shtresat në nevojë. Standarti përmbushet plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të	Uniba ka një strukturë efektive dhe vë në dispozicion të studentëve të programit Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin

<sup>142</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>, (Rubrika Pranimet)

<sup>143</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>, (Rubrika Pranimet)

<sup>144</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>, (Rubrika Pranimet Tarifa dhe Bursa)



<p>plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Arsimor ” një informacion të vazhdueshëm lidhur me kërkesat dhe procedurat për vlerësimin dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin, e sanksionuar në rregulloren e programit të studimit (në nenet 7 deri 23),<sup>145</sup></p> <p>Informimi i studentëve bëhet në javën e parë të mësimimit nga Kordinatori i departamentit dhe pedagogët në prezantimin e planit mësimor syllabuseve, dhe guidës të studentëve, si dhe nga Sekretaria mësimore gjatë tërë procesit mësimor.<sup>146</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UniBa ka një sistem informimi të studentëve të pasqyruar në Rregulloren e studimit (neni 14); Rregullore e Transferimit të studentëve (Kreu III Transferimi i krediteve) lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme.<sup>147</sup></p> <p>Në këtë rast ngrihet një komision ad-hoc që vlerëson numrin e krediteve që mund ti njihen studentit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa ka ngritur një sistem informimi për studentëve që mundëson ato të njihen që në ditën e parë të mësimimit në lëndët që përmban kurrikula si me përmbajtjen ashtu edhe me kriteret e vlerësimit të cilat janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve, dhe në rregulloren e studimit të këtij programi (Kreu III).<sup>148 149</sup></p> <p>Në takimin me studentë u konfirmua se ato merrnin informacion mbi vlerësimin e tyre nga edhe Portalit studentor.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e MSH PSSA (neni 23 dhe 23) janë përcaktuar të gjitha procedurat lidhur me ecurinë e përgatitjes së diplomës si pjesën që lidhet me provimin përfundimtar ashtu edhe me përgatitjen e mikrotezës.</p> <p>Konfirmojmë se UniBa ka edhe një Paketë të provës finale, ku jepen në detaje procedurat e provimit të diplomës.<sup>150</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën Studentët -Alumni jepet një informacion i plotë lidhur me programin e studimit, kriteret dhe procedurat e regjistrimit.</p> <p>Po kështu institucioni shfrytëzon Guidën studentore’ rrjetet sociale dhe javën e informimit ku jepet informacion i plotë lidhur me këtë program<sup>151</sup>.</p>

<sup>145</sup> Rregullore e MSH " PSSA" (Ref.Evidenca Nr.3)

<sup>146</sup> Rregullore e funksionimit të sekretarisë mësimore. ( Ref: Evidenca Nr.13.1 )

<sup>147</sup> Rregullore e Transferimit të studentëve" (Ref.Evidenca. Nr.18.2)

<sup>148</sup> Syllabuset e lëndëve Viti I; II.(Ref: Evidenca Nr.1.4 dhe 2.2)

<sup>149</sup> Rregullore e MSH " PSSA" (Ref.Evidenca Nr.3)

<sup>150</sup> Paketa e mbrojtjes finale ( Ref: Evidenca Nr. 13.3 )

<sup>151</sup> Faqja zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>, Guida



<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se institucioni ka ngritur një sistem informimi të studentëve lidhur me programin e studimit që para rregjistrimit të kandidatëve dhe gjatë vitit për përmbajtjen, ecurinë e vlerësimit të tyre si dhe diplomimit. Institucioni ka e zbaton nje udhëzues "Paketa e provës finale" në ndihmë dhe orientim të studentëve. Standarti përmbushet plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni u jep mundësi studentëve të informohen lidhur me programin e studimit strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen nepërmjet një sistemi informacioni nga drejtime të ndryshme, dhe njësi të caktuara të institucionit etj. Në takimin me studentë u konfirmua se nëpërmjet Kordinatorit të Departamentit; Javës së parë të informimit të studentëve; materialeve të ndryshme në hollin e fakultetit (postera, broshura, materiale audio-vizive); klubet studentore, ata marrin një informacion të plotë dhe të vazhdueshëm lidhur me strukturën dhe organizimin e programit të studimit. <sup>152</sup> Studentët shfrytëzojnë edhe faqen zyrtare (portalin studentor) ku publikohen të dhëna të përditësuara lidhur me programin. <sup>153</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	FSHSTS-it në zbatim të rregullores të UniBa-s ka përcaktuar përgjegjësinë e tërë strukturave të saj për informimin e studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndëve, moduleve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me programin Master i Shkencave në " Puna Sociale në Sistemin Arsimor ". <sup>154</sup> Në takimin me studentë u deklarua se ato mermin informacion si nga pedagogët, Kordinatori i departamentit, sekretaria mësimore, si dhe nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të UniBa-së <sup>155</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	Nga dokumentacioni i paraqitur si dhe nga faqja zyrtare e institucionit UniBa rezulton se ka një sërë veprimtarish që organizohen dhe njësisht (Bordi i karrierës; Zyra e Alumnit dhe karrierës; Dekani i studentëve) që funksionojnë lidhur me

<sup>152</sup>) Vizita në institucion, në ambientet e institucionit.

<sup>153</sup> Faqe zyrtare UniBa <https://umb.edu.al> Fakulteteti SHSTS rubrika programet e studimit

<sup>154</sup> Rregullore e UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr.1.3.)

<sup>155</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al>

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh me kompani dhe institucione shtetërore dhe private që i orientojnë ato drejt një punësimi të suksesshëm. <sup>156</sup> Nga takimi me studentë u konfirmua se ata merrnin vazhdimisht informacion nga zyra e programit të karrierës për mundësitë e punësimit të tyre dhe informacione të tjera të ndryshme si intervista pune, testim orientim dhe këshillim nga ekspertë karriere. <sup>157</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UniBa si institucion ka vënë në dispozicion të studentëve të programit MSH “PSSA” një sistem menaxhimi efektiv (Sekretari mësimor; Dekani i studentëve; Kordinatori i Departamentit) që informojnë studentët për çdo aspekt të veprimtarisë së procesit mësimor dhe veprimtarive të tjera, nepërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor për ti mundësuar atyre një informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me programin. <sup>158</sup> Gjatë vizitës u konstatua se institucioni ka vënë në dispozicion të programit një infrastrukturë të mjaftueshme për realizimin e tij.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga vizita në institucion konfirmohet se institucioni UniBa ka krijuar dhe ka në funksionim një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit të aksesueshëm edhe në faqen zyrtare, platformën Google Classroom, ku studentët marrin informacion për veprimtarinë mësimore gjatë frekuentimit të programit, rregjistrimet në provime dhe rezultatet e vlerësimit, të dhëna për lëndët, mjetet didaktike dhe tekstet. <sup>159 160</sup>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se standarti përmbushet plotësisht, pasi institucioni ka një sistem efektiv të informimit të studentëve për tërë aspektet e programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimit”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishtme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<sup>156</sup> Marrëveshje dhe Bordi i Karrierës. (Ref: Evidenca Nr. 10.3 & 29)

<sup>157</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al> . Rubrika Karriera & Alumni

<sup>158</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al> Rubrika studentët.

<sup>159</sup> Syllabuset e lëndëve ( Ref: Evidenca Nr.2.2 )

<sup>160</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit në Sekretarinë mësimore rezulton se FSHSTS disponon statistika vjetore të studentëve që rregjistrohen për herë të parë, për vitin akademik 2022-23 dhe 2023-24, por meqëse ky program është hapur në Tetor 2022 nuk ka të diplomuar pasi është viti i dytë.<sup>161</sup></p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë mësimore dhe verifikimit të tij gjatë vizitës në institucion në rregjistrin themeltar, rregjistrin e arritjeve akademike, për programin e studimit ka statistika për të gjitha aspektet që lidhen me vazhdimësinë e studimeve të këtij programi.<sup>162</sup> Meqënëse janë pak studentë (gjithsej 23 në dy vitet) dhe nuk ka të diplomuar nuk ka të dhëna për largime transferime apo të diplomuar.</p> <table border="1" data-bbox="632 837 1382 1025"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Studentë të regjistruar në vit të parë</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Studentë të transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>11</td> <td>7,4/10</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>12</td> <td>7,08/10</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	2022-2023	11	7,4/10	-	2023-2024	12	7,08/10	-
Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar										
2022-2023	11	7,4/10	-										
2023-2024	12	7,08/10	-										
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga verifikimi i detyrave dhe përgjegjësi si dhe aktivitetit të sektorëve të këtij institucioni si Sekretarisë mësimore Dekanit të fakultetit, Departamentit dhe Alumni rezulton se këto njësi menaxhojnë të dhënat statistikore lidhur me programin e studimit, dhe i kanë të aksesueshme për të gjithë të interesuarit.<sup>163</sup> Arritjet akademike të studentëve janë të aksesueshme edhe nëpërmjet programit “Portali studentor”<sup>164</sup>.</p>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësiave përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet</p>	<p>Në manualin e cilësisë që disponon UniBa rezulton se është përcaktuar qartë kontrolli periodik nga Njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë dhe Zyra e performancës, për ecurinë e programit MSHPPSA. Njësia ushtron kontrole mbi njësitë përgjegjëse për standartet e cilësisë të brëndshme të institucionit, kurrikulave dhe mësimdhënies, marrin feedback nga studentët lidhur me realizimin e programit, dhe hartojnë raporte periodike që i kalojnë Rektorit.<sup>165 166</sup></p>												

<sup>161</sup> Tabela përmbledhëse në Aneksin e RVB-së (: tabela 21 dhe 23 )

<sup>162</sup> Verifikime ne sekretarine mësimore të dokumentacionit ;Tabela 21 në Aneksin e RVB-së.

<sup>163</sup> Rregullore e funksionimit të sekretarisë (Ref: Evidenca Nr.18.1)

<sup>164</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al> Rubrika studentët (Portali studentor)

<sup>165</sup> Manuali I Cilësisë ( Ref: Evidenca Nr. 60 )

<sup>166</sup> Raport I vlerësimit të studentëve ( Ref: Evidenca Nr. 54)

me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.									
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Konfirmojmë se njësia bazë që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor" Departamenti i Sjelljes dhe shëndetit ka një dokumentacion lidhur me profilin dhe cilësinë e studentëve vetëm në hyrje për këtë program studimi pasi nuk ka akoma studentë të diplomuar, që verifikohet në dokumentacionin e Sekretarisë mësimore. <sup>167</sup>								
<b>Konkluzione</b>	GVJ Mendon se institucioni ka krijuar dhe administron të dhëna për profilin e studentëve të programit të studimit. Ka një proces të vazhdueshëm të përditsimit të të dhënave nëpërmjet kontrolleve dhe pyetsorëve që bëhen me studentë.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UniBa në zbatim të Statutit (neni 55;56.) Politikave të mbështetjes së studentëve dhe struktura organizative të tyre ka të përcaktuar përfshirjen e studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si në Senatën akademik, Këshillin e etikës, Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, Këshillit studentor si vetë organizim i studentëve, në GVB, dhe shoqatat dhe forumet studentore. <sup>168 169</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale,	UniBa si institucion dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit si njësi përgjegjëse e programit të studimit rezulton se ka një përfshirje reale të studentëve në vendimmarrje dhe që përpiqen të japin kontribut në përmirësimin e veprimtarisë e institucionit. Kështu në takimin me studentët u theksua se pyetsori që realizohet për të dhënë opinione mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, i aksesueshëm nga të gjithë, është përfshirë në

<sup>167</sup> Aneksë të RVB (Tabela Nr 21)

<sup>168</sup> Politika të mbështetjes e organizimit të studentëve . ( Ref. Evidenca\_Nr.19.1)

<sup>169</sup> Statuti i UniBa. ( Ref.Evidenca Nr.1.4 )



konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	raportin e punës vjetore të departamentit për përmirsimin e kurrikulës dhe performancës së pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi. <sup>170</sup>		
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në dokumentacionin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë rezulton se gjatë tërë vitit akademik nga sektorët përgjegjës NJSBC ushtrohen kontrole mbi ecurinë e procesit mësimor në programet e studimit që mbulon ajo, me instrumenta që sigurojnë pjesmarrjen e studentëve dhe pasqyrohen në raportin vjetor të njësisë. <sup>171</sup> Nga takimi me studentë u rezultoi se studentët janë të lirë të merrnin pjesë një herë në muaj në mbledhjet e hapura të departamentit si mundësi për të dhe kontributin e tyre në përmirsimin e programit të studimit.		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Fakulteti i Shkencave sociale, turizmit dhe sportit ka bazuar në rregulloren e studimit të UniBa-s (neni 89;90;109) barazine dhe ndershmërinë në vlerësim, si dhe të drejtën e ankimimit, dhe të rishikimit të vlerësimit, të studentëve. <sup>172</sup>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ bazuar në dokumentacionin e analizuar dhe verifikimit gjatë vizitës mendon se UniBa dhe FSHSTS ka garantuar përfshirjen studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse, dhe bën përpjekje për të marrë në konsideratë mendimet e tyre për përmirsimin e programeve të studimit që ajo ofron. Departamenti i Shkencave të sjelljes dhe Shëndetit evidenton kontributin e studentëve në procesin e hartimit apo të ndryshimeve në strukturën apo përmbajtjen e programit mësimor.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.6

<sup>170</sup> Raport i punës vjetore të departamentit 2023-2024. (Ref: Evidenca Nr. 28.2 )

<sup>171</sup> Formular i vlerësimit të lëndëve nga studentet (Ref.Evidenca Nr. 11.2 )

<sup>172</sup> Rregullore e studimit të UniBa-s (Ref: Evidenca Nr.1.3 )



**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UniBa në dispozicion të studentëve të rregjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor" (si edhe rezultojn nga dokumentacioni i paraqitur dhe verifikuar në vizitën e realizuar në institucion), njësi shërbimi dhe informimi të studentëve.</p> <p>Zyra e Pranimi të studentëve; Sekretaria Mësimore; Dekani i Studentëve; Kordinatori i Departamentit; Zyra e Alumnit dhe dhe Karriera; Portali Studentor, si dhe klubet e ndryshme studentore etj, informojnë apo mbështesin studentët në veprimtarinë e tyre mësimore apo aspekte të tjera të jetës së tyre studentore.<sup>173 174</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UniBa si institucion rezultojn se ka një sistem informimi dhe këshillimi të studentëve për tërë veprimtarinë dhe punën mësimor e të tyre, duke e sanksionuar me rregulloren "Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve (neni 5 deri 12) mënyrën e funksionimit të këtij sistemi.<sup>175</sup></p> <p>Për ndjekjen dhe marrjen informacion për përparimin e studentëve rezultojn se funksionon Portali studentor, ku studentët rregjistrohen nga sektori i IT.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe nga takimi me studentë rezultojn se ata marrin shërbim mbështetës lidhur me planifikimin e karrierës dhe realizimin e praktikës profesionale, nga Kordinatori i Departamentit; Dekani i studentëve; Zyra e Alumnit dhe Karrierës; si dhe nga pedagogu përkatës për praktikën profesionale.</p> <p>Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar një sërë veprimtarish që lidhen me këtë informim të studentëve.<sup>176</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me to nepërmjet postës</p>	<p>Zyra Alumnit dhe Karrierës ndjek studentët pas diplomimit duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me to nepërmjet postës</p>

<sup>173</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al>.

<sup>174</sup> Politika të mbështetjes perkrahjes për studentë dhe strukturat organizative. ( Ref: Evidenca Nr. 19.1)

<sup>175</sup> Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve ( neni 5 deri 12).(Ref: Evidenca.Nr. 19.5)

<sup>176</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al>. (Rubrikat Alumni, Karriera, Studentët.)

diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	elektronike, pyetsorëve, aktiviteteve promovuese, dhe harton plane dhe raporte vjetore për gjurmimin e studentëve raporte të cilat janë të aksesueshme për të gjitha njesitë e institucionit në faqen zyrtare të institucionit. <sup>177</sup>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se UniBa ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Standarti përmbushet plotësisht			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton se institucioni UniBa ka të hartuar një sërë manualesh të ndryshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave mësimore si: udhëzues për përdorimin e metodave mësimore; Manualin për mësimdhënien online; Guidën për mësimdhënien online; Udhëzues për përdorimin e strukturës së informacionit TIK, etj. <sup>178 179</sup>

<sup>177</sup> Faqe zyrtare UniBa-s <https://umb.edu.al>. (Rubrikat Karriera, Zyra e Alumnit dhe Karriera, Raport Alumnit)

<sup>178</sup> Udhëzues për metodat e mësimdhënies ( Ref; Evidenca Nr. 11.1)

<sup>179</sup> Manual i mësimdhënies online ( Ref; Evidenca Nr.50 ; 51)

fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni UniBa nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj si: Njësia e zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë; Zyra e Vlerësimit të performancës; Njësitë bazë të fakulteteve, ka hartuar dhe zbaton mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin periodik të procesit të mësimdhënies. Formulari i vlerësimit të performancës së pedagogut nga studentët (evidenca nr.11.2), Formulari i vlerësimit të pedagogut nga kolegët (evidenca nr.8) janë mekanizma ku merret informacion dhe analizohet nga njësitë në analizat vjetore të tyre. <sup>180</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Konfirmojmë se Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit bazuar në “Rregulloret e studimit” “Manualin e Cilësisë” ka garantuar përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Përdorimi i instrumentave të tillë si pyetsorët me studentët nga NJZHKC-së dhe Zyra e vlerësimit të Performancës për vlerësimin e performancës së pedagogëve dy herë në vit para provimeve, vlerësimi i pedagogëve nga kolegët, është një mundësi e mirë për përmisimin e procesit të mësimdhënies. <sup>181</sup> Po kështu rezultojnë se ka një sistem për marrjen dhe menaxhimin e ankesave të studentëve (mëshiruar kjo në rregulloren e UniBa-s dhe formularin për transparencë në vlerësimin e studentëve) e konfirmuar kjo edhe nga takimi me studentë <sup>182</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në faqen zyrtare të UniBa-s në rubrikën “Dossier” institucioni publikon raportin vjetor të vlerësimit të cilësisë, i cili përgatitet nga NjZHKC-së bazuar në analizën e gjetjeve të mekanizmave të monitorimit të procesit mësimor pyetsorë me studentë, vlerësim të performancës nga kolegët etj. <sup>183</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UniBa ka krijuar një përvojë pozitive në promovimin e praktikave të mira që dalin nga mekanizmat që përdor për vlerësimin e performancës dhe veprimtarisë mësimore në institucion, duke përdorur aplikimin edhe pjesmarrjen në projekte dhe qendra kërkimore, mbështetje financiare për pjesmarrje në konferenca shkencore, rishikim të pagës etj, për të nxitur personelin për përmisim të mësimdhënies. <sup>184</sup> <i>Në takimin me stafin akademik nga pjesmarrësit u theksua se kjo nuk ishte e mjaftueshme dhe duhet bërë më shumë për mbështetjen e tyre financiare për pjesmarrjen në konferenca shkencore.</i>

<sup>180</sup> Raporti vjetor UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr. 57 )

<sup>181</sup> Formular I vlerësimit të pedagogëve nga studentët . (Evidenca Nr.11.2)

<sup>182</sup> Formular I transparencës në vlerësimin e studentëve ( Ref: Evidenca Nr.52 )

<sup>183</sup> Raport vjetor I vlerësimit të cilësisë në UniBa ( Ref: Evidenca Nr. 55 )

<sup>184</sup> Promovim I shembujve të praktikave të mira ( Ref:Evidenca Nr. 56 )

<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se Fakulteti I Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit i UniBa-s ndjek një politikë të garantimit dhe promovimit të cilësisë të mësimdhënies dhe të praktikave të mira, në një spektër të gjërë dhe ka qendra trainimi ku dhe hartohen udhëzues për metodat inovative në mësimdhënie. Standarti përmbushet plotësisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga faqja zyrtare e UniBa-s rezulton se institucioni ka ngritur një strukturë të plotë për sigurimin e cilësisë në shkallë fakulteti dhe institucioni. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Komisioni i Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë; Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë; Komisioni i vlerësimit të performancës. <sup>185</sup> Këto struktura punojnë mbi bazën e rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, dhe konkretisht Rregullores e Njësive të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë; Rregullores e Komisionit të Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë. <sup>186</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga vizita në UniBa rezulton se institucioni ka një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë i cili vepron bazuar në legjislacionin dhe rregulloren e miratuar për veprimtarinë e tij, dhe ka një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <sup>187</sup> Studentët kanë përfaqësimin e tyre në këto njësi, dhe rezultojnë nga ekspertiza nga bashkëpunëtor dhe ekspert të jashtëm realizohet nga aktorët e jashtëm të biznesit bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucionin e konsiston në dhënie sugjerimesh lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe përmirësimin të programeve të studimit. <sup>188</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UniBa përdor si vlerësimin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm si dhe ka përcaktuar

<sup>185</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. Rubrika : Fakultete dhe Qendra, ( Barleti Profesional )

<sup>186</sup> Rregullores e Komisionit të Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë. ( Ref: Evidenca Nr. 16 & 16.1.)

<sup>187</sup> Plani i Zhvillimit Strategjik të UniBa-s, 2020-2030) (Ref. Evidenca\_Nr. 5.1)

<sup>188</sup> Marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi ( Ref: Evidenca Nr. 21.1. )



<p>duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>në Rregulloren e Njesisë të zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë, edhe instrumentët përkatës për realizimin e vetvlerësimit si të institucionit ashtu edhe të programeve të studimit<sup>189</sup> Konfirmohet se UniBa i është nënshtruar 2 herë edhe vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional në 2017 nga Agjensia Britanike QAA dhe me vendimin e fundit të BA Nr 60. Datë 16/12/2021 ka marrë vlerësim pozitiv me 5 vite dhe është në proces akreditimi të programeve të studimit që ofron.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni UniBa për grumbullimin e të dhënave për pasqyrimin e gjëndjes në mësimdhënie dhe kërkim reflektuar në analizat vjetore të veprimtarisë në shkallë njësie bazë, njësise kryesore dhe si institucion në tërësi bazohet në instrumenta të qartë e të matshëm (si vetdeklarimet e anëtarëve të stafit akademik, kontrollet e realizuara për mësimdhënien, pyetsorët me studentë, vlerësimi nga kolegët, etj)<sup>190</sup> Mbi bazën e këtyre treguesve rezulton se Institucioni bën edhe promovime nxitëse si emërimet në pozicione të caktuara, mbulim shpenzimesh për veprimtari shkencore, etj.<sup>191</sup></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se institucioni ka ndërtuar një strukturë të plotë dhe transparente për të ndjekur sigurimin e cilësisë, nepërmjet strukturave funksionale mbështetur në rregullore dhe manuale orietuese. Standarti përmbushet plotësisht.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe i verifikuar gjatë vizitës në institucion mund të konkludojmë se institucioni përdor mekanizma</p>

<sup>189</sup> Rregullore e Njesisë të Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë. ( Ref: Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. Rubrika. Sigurimi i cilësisë )

<sup>190</sup> Raportim I punës semestrale të stafit akademik ( Ref: Evidenca Nr. 49 )

<sup>191</sup> Manual I burimeve njerëzore ( Ref: Evidenca Nr. 7.1 faqe 10 "Promovimi i stafit )




<p>mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>të ndryshëm formalë për të realizuar mbikëqyerjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” në shërbim të akreditimit, në përputhje me Manualin për sigurimin e cilësisë. Në këtë manual përcaktohen qartë detyrat e NjZHKC dhe strukturave të tjera për përgatitjen periodike të raporteve të vlerësimit të cilësisë ku evidentohen arritjet dhe dobësitë, si dhe masat që duhen marrë si për promovimi e praktikave të mira ashtu edhe për përmirësimin e procesit mësimor.<sup>192</sup> Gjetjet e NjZHKC pasqyrohen në raportet vjetore të njësisë baze fakultetit dhe institucionit në tërësi dhe publikohen në faqen zyrtare.<sup>193 194</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga verifikimi i raporteve vjetore të punës mësimore dhe shkencore të departamentit dhe të institucionit në tërësi, rezulton se bazuar në rezultatet e vlerësimit të përfituara nga pyetsorët me studentë, vlerësimin e kolegëve dhe vetvlerësimit të pedagogëve, nga njësitë përkatëse, verifikohen rezultatet e pritshme, bëhet edhe evidentimi i praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe përcaktohen mangësitë, dhe kërcënimet lidhur me programet e studimit, dhe jepen rekomandime për përmirësimin e punës mësimore.<sup>195</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konfirmojmë që UniBa në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit, aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta që janë:  Raportim i pedagogëve për punën;  Vlerësimet online cdo semestër nga studentët të mësimdhënies;  Formati i vlerësimit nga kolegët të stafit akademik;  Formati i vetvlerësimit;</p>

<sup>192</sup> Manual I Cilësisë (Ref: Evidenca Nr. 60.)

<sup>193</sup> Raporti i punes vjetore 2022 2023 DSHSSH (Ref: Evidenca Nr.28.1 )

<sup>194</sup> Raporti i punes vjetore UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr. 57)

<sup>195</sup> Raporti i punes vjetore UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr. 57)



<p>kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vëzhgime në auditor; Mbledhje mujore në departament për ecurinë e procesit mësimor; rezultatet e provimeve etj.<sup>196 197</sup></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Konfirmojmë që UniBa në kuadër të vlerësimit të realizimit e ecurisë së programit të studimit aplikon metodologji vlerësimi të tërthorta, për të bërë vlerësimin lidhur me realizimin e programit të studimit. Instrumentat më të aplikuar janë :</p> <p>Sondazhe me studentët aktual që vazhdojnë studimet; Sondazhe dhe mbledhje informacioni nga studentë të diplomuar nga Alumni; Sondazhe me qeverinë studentore Etj <sup>198</sup>, por nuk është paraqitur ndonjë evidence lidhur me këto sondazhe. Në RVB thuhet se pedagogët e jashtëm ekspertë të fushës japin ekspertizë për përmisimin e punës mësimore. <i>Në takimin me stafin akademik u konfirmua se dy pedagogë ekspertë të fushës janë përfshirë si staf PAK dhe kanë dhënë ndihmesë në hartimin dhe ecurinë e programit.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ mendon se standarti përmbushet plotësisht pasi institucioni nëpërmjet njësjive përgjegjëse të programit monitoron përpjekjet që bëhen për realizimin e objektivave të programit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<sup>196</sup> Raportim i punës semestrale stafit akademik. (Ref: Evidenca Nr.49 )

<sup>197</sup> Formular i vlerësimit te lendes dhe pedagogut nga studentet ( Ref:Evidenca Nr. 11.2)

<sup>198</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. ( Rubrika Studentët ); Zyra e Karrierës dhe Alumni (Rubrika Deshmite)

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Konfirmojmë se UniBa dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Turizmit dhe Sportit lidhur me procesin e sigurimit të cilësisë ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në këtë proces. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes të studentëve në komisionin e sigurimit të standarteve dhe cilësisë, të përfshirjes së tyre në tërë grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve sipas njësisë, bashkëpunimin me studentët e diplomuar nëpërmjet Alumnit dhe bashkëpunimi i ngushtë me përfaqësues të bizneseve në rolin e ekspertëve të jashtëm. <sup>199 200 201</sup> <i>Sugjerojmë që këto ekspertë të jenë pjesë e dokumentuar e grupeve të vlerësimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të tij në vizitën në institucion rezulton se Uniba ka të përcaktuar në rregulloret e saj dhe të njësive që merren me sigurimin e cilësisë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për një sigurim të brendshëm të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor". Keto përgjegjësi dhe detyra janë përcaktuar në Rregulloren e UniBa-s ( neni 13;14;15.); në Rregulloren e Departamentit SHSTS ( neni 11); Rregulloren e programit të studimit MSH PSSA( neni 34 ); Rregullore për vlerësimin e performancës ( neni 3 deri 9); Rregullore e njësive të zhvillimit të kurrikulave dhe cilësisë ( neni 3;4;5;7, faqja zyrtare); Manuali i cilësisë ( evidenca nr.60); Plani i punës për zhvillimin e kurrikulave dhe cilësisë ( evidenca nr.59)
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe shqyrtimi i veprimtarive që organizon UniBa lidhur me sigurimin e cilësisë të programit mund të konkludojmë se në procesin e sigurimit të cilësisë të programit të studimit Master i Shkencave në "Punë Sociale në Sistemin Arsimor" institucioni ngarkon me përgjegjësi njësinë kryesore dhe bazë, kordinatorin e departamentit si dhe të gjitha strukturat ndihmëse të saj. Në kuadër të akreditimit të programit është ngritur edhe grupi i vlerësimit të brendshëm me pjesëmarrjen e stafit, studentëve, dhe në urdhërin nr.45 të datës 22/12/2023 janë përcaktuar qartë edhe strukturat akademike dhe administrative mbështetëse për dhënien e

<sup>199</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. ( Sigurimi i cilësisë )

<sup>200</sup> Marrëveshje bashkëpunimi brenda vendit ( Ref: Evidenca Nr. 10.3)

<sup>201</sup> Plani strategjik Alumni dhe Karriera ( Ref: Evidenca Nr. 58 )

studentëve të programit të studimit.	informacionit që kërkohet. Në takimin me drejtues të fakultetit dhe NJzhkc u theksua se ky grup do të mbështesë vazhdimisht procesin e sigurimit të cilësisë.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe verifikimit gjatë vizitës në UniBa, konstatojmë se në Statutin (neni 3, pika 3) dhe Kodin e Etikes të institucionit, në procesin e përfshirjes dhe aktivizimit të stafit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit, respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit, dinjiteti njerëzor, duke siguruar një trajtim të barabartë të pedagogëve, studentëve dhe vartësve. <sup>202</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	UniBa si institucionka bërë pjesë aktive të procesit të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë të programit Master i Shkencave në “Puna Sociale në Sistemin Arsimor” gjithë bashkëpunëtorët e përfshirë në realizimin e këtij programi studimi, nëpërmjet bashkëveprimit me studentë të diplomuar, institucionet bashkëvepruese për të marrë ekspertizë lidhur me ecurinë e programit. <sup>203 204</sup> Vlerësimet mendimet e tyre gjenerohen nga organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, mbledhje apo tryeza të rumbullakta dhe merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të programit.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ mendon se institucioni cilësisë ka ndërtuar një sistem bashkëveprimi mes aktorëve të ndryshëm të brëndëshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë, duke përcaktuar në rregulloret e saj dhe të njëjve që merren me sigurimin e cilësisë, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për një sigurim permanent të brëndëshëm të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor” ku respektohen standartet dhe integriteti akademik i stafit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<sup>202</sup> Kodi i Etikës në UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr.1.5.) Statuti i UniBa-s ( Ref: Evidenca Nr. 1.4 )

<sup>203</sup>Marreveshje bashkepunimi te UniBa-s brënda vendit ( Ref: Evidenca\_Nr 10.3)

<sup>204</sup> Vendim ngritje të Bordit të Karrierës. (Ref:Evidenca Nr. 29)



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Konfirmojmë se UniBa si institucion ka një sistem organizimi transparent të sigurimit të brëndëshëm të cilësisë, bazuar në politikat dhe strategjinë e saj të zhvillimit. Në faqen zyrtare të institucionit në rubrikën “Sigurimi i cilësisë” janë bërë publike të gjitha rregulloret, strukturat dhe veprimtaritë që lidhen me sigurimin e brëndëshëm të cilësisë.<sup>205</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi në faqen zyrtare të tij rezulton që UniBa publikon të gjitha raportet e vlerësimit të brëndëshëm të programeve të studimit të realizuara deri në vitin akademik 2017-2018 në rubrikën “Dossier”, por nuk ka asnjë RVB për programin Master I Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimor”<sup>206</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në raportet e vlerësimit të brëndëshëm të programeve të studimit bëhet analiza SWOT ku evidentohen si pikat e forta ashtu edhe mangësitë, rekomandimet përkatëse si objekt punë për njësitë për hartimin e një plani masash për përmirësimin e punës.<sup>207</sup> Nuk ka një plan të tillë për programin.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe me studentë konfirmohet se tërë procesi i punës procedurat dhe instrumentat e përdorur për sigurimin e cilësisë,ku edhe studentët janë pjesë e tij, ka patur një ndikim pozitiv në përmirësimin cilësor të programit të studimit, sidomos në përmirësimin e syllabuseve,të metodologjisë dhe veprimtarive jashtë procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>UniBa nepërmjet veprimtarive periodike të organizuara me stafin akademik dhe studentë, si dhe me manuale të shumtë të publikuar në faqen zyrtare të institucionit lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ka siguruar një ndërgjegjësim të tërë aktorëve pjesëmarrës në procesin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin të programeve të studimit.<sup>208</sup></p>

<sup>205</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. ( Sigurimi i cilësisë )

<sup>206</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. ( Rubrika Dossier )

<sup>207</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al>. ( Rubrika Dossier )

<sup>208</sup> Faqja Zyrtare e UniBa-s <https://umb.edu.al> ( Rubrikat Sigurimi i Cilësisë; Karriera,Alumni; Veprimtari etj.)



afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.				
<b>Konkluzione</b>	GVJ mendon se UniBa si institucion ka krijuar një kulturë të brëndëshme për ruajtjen dhe përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë nepërmjet politikave që ndjek, proceseve dhe veprimtarive që organizon.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Punë Sociale në Sistemin Arsimit” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Univeriteti Barleti”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Hartimi i programit që ofron Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe Shendetit në Fakultetin e Shkencave Sociale Turizit dhe Sportit në IAL UniBa, në koherencë me vizionin, misionin dhe planin e zhvillimit strategjik të institucionit si dhe mbështetja dhe përdorimi i një kornize rregullatore, e cila ka siguruar zbatimin e kërkesave të ligjit dhe të kërkesave të tregut.
2. Cilësia e personelit akademik që jep mësim në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit e mbështetur nga një politikë dhe një sistem funksional për menaxhimin e personelit të institucionit që përfshin: politikën dhe procedurat e rekrutimit, të vlerësimit të performancës së personelit, të promovimit të personelit, të menaxhimit të të dhënave të personelit.
3. Infrastruktura moderne për mësimdhënie, hapësirat e nevojshme dhe adekuate, për mësimdhënie dhe studim individual, të bollshme dhe mirë të organizuara, bibliotekë funksionale në shërbim të stafit dhe studentëve për të përmbushur rezultatet e pritshme në programin e studimit Master i Shkencave në "Puna Sociale në Sistemin Arsimit" që ofron ky institucion.
4. Përfshirja e studentëve të diplomuar nepërmjet ALUMNI-t në përmisimin e objektivave dhe përmbajtjes të programit të studimit Master i Shkencave në "Puna Sociale në


Sistemin Arsimor " duke shfrytëzuar pjesmarrjen e tyre në veprimtaritë e organizuara nga Departamenti, dhe ekspertizën që ata ofrojnë.

#### **Pika të dobta**

1. Numri i pakët i studentëve të rregjistruar në dy vite. **[(Standarti V/4 Kriteri 2)]**
2. Mungesa e ambienteve të veçanta për lëndë specifike si Këshillim individual dhe në grup; Praktikë klinike në kontekstin e shkollës me femijët dhe familjen. **[(Standarti IV.2/ Kriteri 3)]**
3. Në disa nga syllabuset e programit të studimit Master i Shkencave "Puna Sociale në Sistemin Arsimor" ka një numër të pakët të literaturës së rekomanduar (duke patur parasysh se kemi të bejmë më një nivel të dytë studimi) dhe kërkohet përditësim i saj. **[(Standarti IV.3 / Kriteri 1;2.)]**
4. Mungesa e qëndrueshmërisë së stafit akademik që mbulojnë lëndët e programit të vitit të parë në vitin akademik 2022-2023 me 2023-2024. **[(Standarti IV.1 /Kriteri 3)]**

#### **Rekomandime**

1. Rekomandojmë që fakulteti që mbulon këtë program studimi të ngrejë mjedise mësimore në përputhje me natyrën specifike të programit për lëndët " Këshillim individual dhe në grup", "Praktikë klinike në kontekstin e shkollës me femijët dhe familjen" të pajisura me infrastrukturën fizike dhe njerëzore të nevojshme për aftësimin praktik të studentëve.
2. Rritjen e stafit akademik efektiv të përfshirë në mbulimin e lëndëve të kurrikulës së këtij programi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë të tij.
3. Shtimin e numrit të titujve në literaturën e rekomanduar të programeve të lëndëve në përputhje me nivelin e këtij programi "Master Shkencor" dhe përditësimi i saj në disa programe me literaturë të 5 viteve të fundit.
4. Rekomandohet që të punohet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.
5. Rekomandohet që UniBa të parashikojë rritjen e buxhetit në "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", për kërkimin shkencor bazë, për veprimtaritë shkencore si edhe për botime me faktor impakti.



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Social Work in Educational System" provided by the Higher Education Institution "Barleti University"**

**Strengths and affirmations**

1. Drafting of the program offered by the Department of Behavioral and Health Sciences at the Faculty of Social Sciences, Tourism and Sport at HIE UniBa, in coherence with the vision, mission and strategic development plan of the institution, as well as the support and use of a regulatory framework, which has ensured the implementation of the requirements of the law and the market.
2. The quality of the academic staff who teach at the Faculty of Social Sciences, Tourism and Sports, supported by a policy and a functional system for the management of the institution's personnel, which includes: the policy and procedures of recruitment, evaluation of personnel performance, personnel promotion, personnel data management.
3. Modern infrastructure for teaching, necessary and adequate spaces for teaching and individual study, spacious and well organized, functional library at the service of staff and students to meet the expected results in the study program Master of Science in "Social Work in Educational System" offered by this institution.
4. Involvement of graduate students through ALUMNI in improving the objectives and content of the study program Master of Science in "Social Work in the Educational System" using their participation in the activities organized by the Department, and the expertise they offer.

**Weaknesses**

1. The small number of students registered in two years. [(Standard V/4 Criterion 2)].
2. Lack of special facilities for specific subjects such as "Individual and group counseling"; "Clinical practice in the school context with children and families". [(Standard IV/2 criterion 3)]
3. In some of the syllabuses of the Master of Science study program "Social Work in the Educational System" there is a small number of recommended literature (taking into account that we are dealing with a second level of study) and its updating is required. [(Standard IV/3. Criterion 1;2.)]
4. The lack of sustainability of the academic staff covering the subjects of the first year program in the academic year 2022-2023 and 2023-2024. [(Standard IV/ 1 Criterion 3)]

## Recommendation

1. We recommend that the faculty covering this study program set up learning environments in accordance with the specific nature of the program for the subjects "Individual and group counseling" and "Clinical practice in the school context with children and families" equipped with the necessary physical and human infrastructure for the practical training of students.
2. Increasing the effective academic staff involved in covering the curriculum subjects of this program and ensuring its sustainability.
3. Adding the number of titles in the recommended literature of the subject programs in accordance with the level of this "Master of Science" program and updating it in some programs with literature of the last 5 years.
4. It is recommended to work on increasing the mobility of students from this study program.
5. It is recommended that UniBa foresee the increase of the budget in "Basic Fund for scientific research and scientific activities", "for basic scientific research", "for scientific activities" as well as "for publications with an impact factor

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA,				X

<b>VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>



